

Nr. 3/4 Regj. Themeltar
Nr. 3/4 Vendimi

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i përbërë nga gjyqtarët:

Medi Bici	Kryesues
Ardian Dvorani	Anëtar
Artan Zeneli	Anëtar
Tom Ndreca	Anëtar
Admir Thanza	Anëtar

Asistuar nga sekretarja gjyqësore Elona Kardhiqi, sot me datë 10.06.2015 përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqësore çështjen penale nr.04 të vitit 2014, e cila u përket palëve ndërgjyqëse të mëposhtme:

KËRKUESE: PROKURORIA E PËRGJITHSHME E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, *përfaqësuar në gjyq nga prokurorët Adnand Xholi dhe Artur Selmani.*

TË PANDEHUR: 1. ARBEN NDOKA, *i biri i Ndues dhe Diles, i vitlindjes 1974, lindur në Skuraj Kurbin, banues në Lezhë, lagjja “Besëlidhja”, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, me arsim të lartë, i martuar, me detyrë deputet në Kuvendin e Shqipërisë, i padënuar, mbrojtur në gjyq nga Av. Ardian Visha.*

A K U Z U A R:

Për veprën penale të goditjes për shkak të detyrës,
të parashikuar nga neni 237 i Kodit Penal.

2. PJERIN NDREU, *i biri i Zefit dhe Diles, i vitlindjes 1966, lindur në Pukë dhe banues në Tiranë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, me arsim të lartë, i martuar, me detyrë deputet i Kuvendit të Shqipërisë, i padënuar, mbrojtur në gjyq nga Av. Baftjar Rusi.*

A K U Z U A R:

Për kryerjen e veprës penale të goditjes për shkak të detyrës,
të parashikuar nga neni 237 i Kodit Penal.

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË

pasi e bisedoi çështjen në tërësi, administroi provat; dëgjoi prokurorët Adnand Xholi dhe Artur Selmani në konkluzionet përfundimtare, të cilët kërkuan:

Deklarimin fajtor të pandehurit Arben Ndoka për kryerjen e veprës penale të goditjes për shkak të detyrës të deputetit Gent Strazimiri, parashikuar nga neni 237 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burgim.

Pezullimin e këtij dënimi dhe zëvendësimin e tij me detyrimin për të përmbushur një punë në interes publik, me pëlqimin e tij dhe pa shpërblim, në favor të interesit publik, në një masë të përgjithshme prej 150 orë pune.

Nëse i pandehuri refuzon pezullimin e dënimit dhe zëvendësimin e tij me kryerjen e një pune në interes publik pa shpërblim, në favor të interesit publik, ndaj tij të ekzekutohet dënimi prej 1 (një) vit burgim.

Deklarimin fajtor të pandehurit Pjerin Ndreu për kryerjen e veprës penale të goditjes për shkak të detyrës të deputetit Gent Strazimiri, parashikuar nga neni 237 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 8 (tetë) muaj burgim.

Pezullimin e këtij dënimi dhe zëvendësimin e tij me detyrimin për të përmbushur një punë në interes publik, me pëlqimin e tij dhe pa shpërblim, në favor të interesit publik, në një masë të përgjithshme prej 100 orë pune.

Nëse i pandehuri refuzon pezullimin e dënimit dhe zëvendësimin e tij me kryerjen e një pune në interes publik pa shpërblim, në favor të interesit publik, ndaj tij të ekzekutohet dënimi prej 8 (tetë) muaj burgim.

Avokati Ardian Visha, i cili mbrojti në gjyq të pandehurin Arben Ndoka në konkluzionet përfundimtare kërkoj:

Ndryshimin e kualifikimit ligjor të faktit nga neni 237 i Kodit Penal në nenin 90 të Kodit Penal.

Pushimin e gjykimit për ves procedural, që lidhet me kushtin e procedimit e që konsiston në detyrimin ankimes të personit të dëmtuar nga vepra penale.

Avokati Baftjar Rusi, i cili mbrojti në gjyq të pandehurin Pjerin Ndreu në konkluzionet përfundimtare kërkoj:

Deklarimin e pafajshëm të pandehurit Pjerin Ndreu për veprën penale që akuzohet.

Të pandehurit në fjalën e tyre të fundit u shprehën se janë dakord me ato çfarë thanë mbrojtësit e tyre.

Si edhe dëgjoi edhe relatimin e gjyqtarit Medi Bici, në përfundim

V Ë R E N

1. Në datën 09.10.2014 është regjistruar në Gjykatën e Lartë çështja penale nr.04-2014 regj. them që u përket të pandehurve Arben Ndoka dhe Pjerin Ndreu, të akuzuar për veprën penale të goditjes për shkak të detyrës, të parashikuar nga neni 237 i Kodit Penal.

2. Të pandehurit Arben Ndoka dhe Pjerin Ndreu, si dhe i dëmtuari nga vepra penale Gent Strazimiri janë deputet në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

3. Në datën 10.07.2014, në sallën e seancave parlamentare të Kuvendit të Shqipërisë është zhvilluar seanca plenare, në rendin e ditës së të cilës ishte diskutimi për projektligjin “Për armët”, i propozuar nga qeveria.

4. Gjatë zhvillimit të punimeve të kësaj seance plenare e ka marrë fjalën për diskutim edhe deputeti i Partisë Demokratike, i dëmtuari Gent Strazimiri, i cili, ndërmjet të tjerave, i është drejtuar Kryeministrit, që të mos vishte me pushtet njerëz të botës së krimit dhe tu hiqte sa më parë mandatin e deputetit personave me rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe të dënuar për vepra të rënda penale.

5. Gjatë fjalës së tij kanë qenë të pranishëm në sallën e seancave plenare edhe dy deputetët e Partisë Socialiste, të pandehurit Arben Ndoka dhe Pjerin Ndreu.

6. Pas përfundimit të fjalës nga i dëmtuari, deputeti Gent Strazimiri, e ka marrë fjalën deputetja Olta Xhaçka, e cila ka insistuar që i dëmtuari të jepte emrat e deputetëve që ishin me precedentë penal (rekorde kriminale), por nga ana e këtij të fundit është dhënë përgjigje që emrat do t’i bëheshin të ditur publikut në një moment të mëvonshëm.

7. Pasi ka përfunduar fjalën e tij, i dëmtuari, deputeti Gent Strazimiri, është larguar nga salla ku zhvillohen punimet e Kuvendit, për një pushim të shkurtër, duke qëndruar në korridorin në krah të sallës plenare të tij.

8. Pak minuta pasi i dëmtuari Gent Strazimiri kishte dalë nga salla ku zhvillohen punimet e Kuvendit, nga ajo sallë është larguar edhe i pandehuri Arben Ndoka, i cili, duke lëvizur në korridorin në krah të sallës, është drejtuar për tek i dëmtuari Gent Strazimiri. Fillimisht e ka kapur nga xhaketa në krahun e djathtë dhe, më pas, e ka qëlluar atë dy herë me grusht në pjesën e kokës.

9. Për të ndaluar vazhdimin e këtij veprimi të dhunshëm kanë ndërhyrë në çast punonjësit e Shërbimit të Sigurisë në Kuvend, ndërmjet tyre edhe dëshmitari Erion Kolaveri. Kanë dalë gjithashtu në korridor edhe disa deputetë, ndërmjet të cilëve dëshmitarët Genc Pollo dhe Klodiana Spahiu. Ndërhyrja e punonjësve të gardës dhe e deputetëve të Kuvendit kanë bërë të mundur që të ndërpritej veprimi i dhunshëm i kryer nga i pandehuri Arben Ndoka ndaj të dëmtuarit Gent Strazimiri.

10. Pak çaste më vonë, një deputet tjetër, i pandehuri Pjerin Ndreu, është afruar nga prapa të dëmtuarit Gent Strazimiri dhe, megjithëse në praninë dhe ndërhyrjen e dëshmitarit Genc Pollo dhe të deputetëve të tjerë, duke përdorur fjalë fyese, e ka qëlluar me pëllëmbë të dëmtuarin Gent Strazimiri në pjesën e pasme të kokës.

11. Në lidhje me këtë ngjarje dhe për shkeljet disiplinore të konstatuara në veprimet e kryera nga ana e deputetëve, mbështetur në Rregulloren e Kuvendit, me vendimin nr.14, datë 11.07.2014, Byroja e Kuvendit ka vendosur të marrë këto masa disiplinore: përjashtimin e të pandehurve, deputetëve Arben Ndoka dhe Pjerin Ndreu, përkatësisht, për 7 ditë dhe 3 ditë, nga pjesëmarrja në komisionet parlamentare dhe në seancë plenare. Ndërsa për të dëmtuarin, deputetin Gent Strazimiri është vendosur që t’i jepet masa disiplinore “vërejtje”.

12. Duke u bazuar në kallëzimin e bërë nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike në datën 14.07.2014, Prokuroria e Përgjithshme ka regjistruar procedimin penal nr.01 të vitit 2014 dhe, pasi ka përfunduar hetimet paraprake, ka sjellë për gjykim para Gjykatës së Lartë të pandehurit Arben Ndoka dhe Pjerin Ndreu, të akuzuar për veprën penale të goditjes për shkak të detyrës të të dëmtuarit Gent Strazimiri, parashikuar nga neni 237 i Kodit Penal.

13. Ushtrimi i ndjekjes penale ndaj deputetëve të Kuvendit, të pandehurve Arben Ndoka dhe Pjerin Ndreu, nga vetë Prokuroria e Përgjithshme dhe paraqitja e kërkesës për gjykimin e tyre pranë Gjykatës së Lartë, është bazuar në nenin 141 të Kushtetutës dhe në nenin 75/b të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet se Gjykata e Lartë ka juridiksion fillestar kur gjykon akuzat penale kundër deputetëve të Kuvendit, kur këta janë në këto funksione në kohën e

gjykimit. Akuza ndaj tyre mbështetet në nenin 237 të Kodit Penal ku parashikohet se: *“Goditjet ose vepra të tjera dhune që i bëhen punonjësit që kryen një detyrë shtetërore apo një shërbim publik, për shkak të veprimtarisë së tij shtetërore apo të shërbimit, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet”*.

14. Kolegji Penal vlerëson se faktet për të dy të pandehurit janë të ndarë nga njëri-tjetri në një interval të shkurtër kohe. Me veprime të pavarura të pandehurit kanë goditur të njëjtin të dëmtuar, deputetin Gent Strazimiri. Prandaj akuzat ndaj tyre nuk lidhen me njëra-tjetrën dhe për rrjedhojë ekzistenca e fakteve për to duhet të analizohen të veçuara.

15. Ekzistenca e faktit për të pandehurin Arben Ndoka provohet nga deklaratimet e dëshmitarëve Gent Strazimiri (i dëmtuari), Genc Pollo, Erion Kolaveri, Gentian Shulku dhe Klodiana Spahiu të bëra para Kolegjit Penal. Ekzistencën e faktit e provojnë gjithashtu edhe pamjet e DVD-së të datës 10.07.2014, e cila u shikua në monitor në seancën gjyqësore të datës 16.03.2015, si dhe nga provat e tjera që ndodhen në fashikullin hetimor dhe të administruara në gjyq.

16. I dëmtuari Gent Strazimiri në seancën gjyqësore të datës 12.01.2015 ndërmjet të tjerave ka deklaruar se: *“...Me datë 10.07.2014 ka qenë seanca parlamentare dhe kemi diskutuar ligjin “Për armët”*. Pas ministrit të brendshëm, unë kam folur për fenomenin e krimit dhe përdorimit të armëve. Kam theksuar se pas rrotacionit politik administrata është mbushur me kriminelë, të cilët kanë depërtuar me vullnetin e Kryeministrit. Kam thënë se në parlament ka 19 deputetë me rekorde kriminale, por nuk kam përmendur emra. Pasi kam përfunduar fjalën kam dalë në korridor dhe kam qenë duke folur në telefon, kur më afrohet i pandehuri Arben Ndoka, i cili më kapi për xhakete në anën e djathtë dhe më ka goditur dy herë me grusht në kokë në pjesën e ballit....

17. Thëniet e të dëmtuarit lidhen me thëniet e dëshmitarëve të tjerë të sipërcituar, si edhe nga pamjet që pasqyrohen në DVD-i.

18. Vetë i pandehuri Arben Ndoka në seancë gjyqësore pranon që ka kryer veprime të dhunshme duke e goditur të dëmtuarin, deputetin Gent Strazimiri, madje duke shprehur edhe pendesën e tij për gjestin e kryer.

19. Provat e mësipërme të marra në tërësi e bindin plotësisht gjykatën tej çdo dyshimi të arsyeshëm se fakti ka ndodhur. I pandehuri Arben Ndoka ka kryer veprime të dhunshme duke e goditur të dëmtuarin Gent Strazimiri, gjatë zhvillimit të veprimtarisë parlamentare, pas deklaratimeve të këtij të fundit në seancën plenare, në ambientet e Kuvendit të Shqipërisë (korridorët e tij), jashtë sallës ku zhvillohet seanca plenare.

20. Ekzistenca e faktit në lidhje me të pandehurin Pjerin Ndreu provohet nga deklaratimet e të dëmtuarit Gent Strazimiri dhe dëshmitari Genc Pollo, të bëra para gjykatës, nga pamjet e DVD-së, si dhe provat e tjera që ndodhen në fashikullin hetimor dhe të administruara në seancë gjyqësore.

21. Në seancë gjyqësore, i dëmtuari Gent Strazimiri, ndërmjet të tjerave, ka deklaruar se: *“...pas disa minutash nga goditjet që mora nga i pandehuri Arben Ndoka, më vjen nga prapa i pandehuri Pjerin Ndreu, i cili pasi më ofendoi më goditi pas kokës. Në këtë kohë ai ishte i shoqëruar nga deputetët Armando Prenga dhe Parid Cara....*

22. Ndërsa dëshmitari Genc Pollo në seancën gjyqësore të datës 12.01.2015, ka deklaruar edhe se: *“...kur dola në korridor më thonë që Ndoka ka goditur Strazimirin...Unë pashë Pjerin Ndreun bashkë me një person tjetër që u afruan. Nuk kam parë nëse e ka goditur Ndreu, pasi unë hyra për ti ndarë dhe ai e kaloi dorën pas kokës time....*

23. I pandehuri Pjerin Ndreu, si gjatë fazës së hetimit paraprak, ashtu edhe gjatë gjykimit, ka mbajtur një qëndrim mohues, duke pretenduar që ai nuk e ka goditur të dëmtuarin Gent

Strazimiri. Nga pamjet filmike të DVD-së që u shfaq para gjykatës shikohet qartë se dora e të pandehurit Pjerin Ndreu ka patur kontakt me pjesën e pasme të kokës të të dëmtuarit Gent Strazimiri.

24. Të marra në unitet, provat e sipërcituara i krijojnë Kolegjit Penal bindjen e plotë dhe tej çdo dyshimi të arsyeshëm se fakti i kryerjes së veprave të fyerjes dhe asaj të të veprave dhunës me anë goditjes së të dëmtuarit Gent Strazimiri nga i pandehuri Pjerin Ndreu kanë ndodhur gjatë zhvillimit të veprimtarisë parlamentare, pas deklarimeve të të dëmtuarit Gent Strazimiri në seancën plenare të Kuvendit, në ambientet e Kuvendit të Shqipërisë (korridorët e tij), jashtë sallës ku zhvillohet seanca plenare.

25. Në këto rrethana të faktit, duke pasur parasysh parimet dhe normat kushtetuese, si edhe normat e tjera që rregullojnë veprimtarinë e Kuvendit dhe ato të ligjit material e procedural penal, Kolegji Penal vlerëson se, bazuar në paragrafin e parë të nenit 387 të Kodit të Procedurës Penale, çështja nuk duhet të fillonte për shkak se nuk bën pjesë në juridiksionin gjyqësor penal.

26. Pra, nisur nga parashikimet e posaçme kushtetuese dhe ligjore, të zbatueshme për vetë natyrën e posaçme të subjekteve aktivë dhe pasivë, si edhe për vetë natyrën e veprimtarisë dhe vendit ku janë zhvilluar rrethanat e faktit objekt të këtij gjykimi, Kolegji Penal vëren se jemi përpara rastit kur vetë organi i procedimit penal, qysh në fazën e hetimit paraprak, duhet të konstatonte mungesën e juridiksionit penal, duke disponuar mosfillimin e çështjes apo pushimin e saj, për shkak se ky fakt konkret nuk parashikohet nga ligji si vepër penale dhe ndjekja penale nuk duhet të fillohej.

27. Kolegji Penal vjen në këtë përfundim, duke identifikuar ligjin e zbatueshëm dhe interpretimin e tij, në funksion të zgjidhjes së drejtë të çështjes, duke mbajtur parasysh dhe duke u udhëhequr, para së gjithash, nga parimet e normat kushtetuese.

28. Në këtë gjykim, Kolegji Penal është investuar nga Prokuroria e Përgjithshme për të shqyrtuar akuzën e ngritur prej saj kundër dy deputetëve të Kuvendit, Arben Ndoka dhe Pjerin Ndreu, sipas nenit 237 të Kodit Penal, të akuzuar se, me anë të veprimeve të dhunshme, kanë goditur për shkak të detyrës një deputet tjetër të Kuvendit, të dëmtuarin Gent Strazimiri, në ambientet e Kuvendit, gjatë zhvillimit të veprimtarisë parlamentare dhe të motivuar mbi kundërshtinë e tyre ndaj qëndrimeve dhe opinioneve të shprehura nga ky deputet i dëmtuar në punimet e asaj dite në seancën plenare të Kuvendit.

29. Prandaj, nisur nga garancitë mbi pozicionin kushtetues të Kuvendit dhe funksionimit të tij, si edhe nga garancitë mbi lirinë parlamentare, kuptimin, mënyrat dhe kufijtë e shprehjes së mendimit dhe të votës nga deputetët e Kuvendit gjatë veprimtarisë parlamentare, detyrimi parësor i Kolegjit Penal është të vlerësojë nëse veprimet a mosveprimet e deputetëve të akuzuar penalisht, si edhe ato të deputetit të dëmtuar, përmbajnë elementët e nevojshëm juridikë që e kualifikojnë çështjen në juridiksionin e zakonshëm gjyqësor administrativ, civil a penal (nëse ky fakt parashikohet nga ligji si vepër penale) apo në juridiksionin e posaçëm, ekskluziv, disiplinor të Kuvendit.

30. Kështu, bazuar në parimet kushtetuese dhe ligjin e zbatueshëm, Kolegji Penal vlerëson të analizojë dhe të verifikojë nëse sjellja dhe veprimet konkrete materiale të deputetëve të pandehur kundrejt deputetit të dëmtuar, gjatë zhvillimit të seancës plenare të Kuvendit të datës 10.07.2014, e të cilësuar nga organi i prokurorisë si vepër penale e goditjes për shkak të detyrës sipas nenit 237 të Kodit Penal, bëjnë ose jo pjesë në format dhe mënyrat e shfaqjes e të shprehjes së qëndrimeve, opinioneve dhe të votës gjatë veprimtarisë parlamentare, të garantuara nga pika 1 e nenit 73 të Kushtetutës e që sjellin mungesën e përgjegjësisë civile a penale të deputetëve. Nëse po, Kolegji Penal vlerëson se duhet të analizohet dhe të verifikohet nëse janë këto sjellje e veprime tejkalim i lirisë së shprehjes dhe të mendimit parlamentar e, në këtë rast, cila është dega

e pushtetit shtetëror dhe cili është organi përkatës që ka kompetencën për të shqyrtuar, gjykuar dhe ndëshkuar këto sjellje e veprime në shkelje të lirisë parlamentare.¹

31. Ky Kolegj Penal, si gjykatë fakti dhe ligji, për zgjidhjen e drejtë të çështjes, ka detyrimin që të analizojë e të interpretojë dispozitat ligjore, përfshirë edhe ato penale, nisur nga parimet dhe përmbajtja e dispozitave të Kushtetutës dhe jo nga e kundërta.

32. Kushtetuta përbëhet, mbi të gjitha, nga rregulla parimore të cilat veprojnë e duhet të kuptohen në mënyrë sistematike, në lidhje të ngushtë me njëra-tjetrën dhe jo në mënyrë të veçuar. Parimet dhe rregullat që përmban Kushtetuta, jo vetëm që përbëjnë bazën ku mbështetet nxjerrja dhe zbatimi i legjislacionit, por i shërbejnë gjyqtarit të përmbushë detyrën e tij në gjykimin e zgjidhjen e çështjeve, duke i interpretuar dhe zbatuar drejt dispozitat e tjera normative, gjithmonë sipas qëllimeve dhe kuptimit të natyrshëm që përmbahet në të gjithë sistemin e parimeve dhe normave kushtetuese.²

33. Kolegji Penal vlerëson të evidentojë edhe se, në shqyrtimin e çështjeve që u paraqiten për shqyrtim, ku palë janë deputetë të Kuvendit dhe që mund të lidhen me veprimtari parlamentare apo me veprime të kryera në ambientet e Kuvendit, gjykatat kanë të drejtën dhe detyrimin që, paraprakisht, të verifikojnë e interpretojnë, në këndvështrimin parimor kushtetues, nëse ekzistojnë rrethanat dhe arsyet që lidhen me respektimin e garancive kushtetuese të parashikuara nga nenet 73 pika 1 dhe 75 pika 2 të Kushtetutës mbi pavarësinë dhe autonominë e veprimtarisë së Kuvendit, si edhe të garancive (të quajtura edhe “privilegje” apo “prerogativa”) të deputetëve në lidhje me sjelljet, shprehjen e mendimeve dhe votimin në ushtrimin e funksionit të tyre kushtetues e që sjellin mungesën e përgjegjësisë civile a penale të deputetit.

34. Prandaj, në raste të tilla, gjykata fillimisht kufizohet në gjykim, duke vënë në bisedim dhe disponuar nëse, faktet që gjykohen, lidhen me ekzistencën e garancive kushtetuese të deputetit sipas nenit 73 të Kushtetutës e që janë në funksion të përmbushjes së kompetencave dhe veprimtarive parlamentare të Kuvendit sipas nenit 75 të saj. Nëse provohet ekzistenca dhe veprimi i këtyre garancive, shqyrtimi gjyqësor i çështjes nuk mund të vazhdojë më dhe ajo duhet të pushohet.³

35. Kjo qasje në gjykimin e çështjes vjen për shkak se këto garanci janë të nivelit kushtetues dhe gjykatat e zakonshme nuk mund të shprehen e disponojnë lidhur me respektimin e tyre thjesht nisur nga mënyra se si ushtrohen ato garanci. Juridiksioni gjyqësor nuk mund të ndërhyjë në vlerësimin dhe gjykimin e çështjeve të tilla. I përket vetëm Kuvendit, si juridiksion ekskluziv, të gjykojë e të vendosë për ekzistencën ose jo të shkeljeve që përbëjnë tejkalim të kufijve të veprimit të garancive mbi lirinë parlamentare të shprehjes dhe votës, për ekzistencën e sjelljeve të atilla që cenojnë autoritetin e Kuvendit, pavarësinë e papërgjegjshmërinë e deputetëve të tij në përmbushjen e detyrës.⁴

¹ITALIA. Corte Costituzionale, sentenza no. 137/2001

²ITALIA. Corte Costituzionale, sentenza no. 1/2013

³MBRETËRIA E BASHKUAR (UK), Joint Committee on Parliamentary Privilege, Parliamentary Privilege, Report of Session 2013–14 :

“ 14. ...the work of Parliament is central to our democracy, and its proceedings must be immune from interference by the executive, the courts or anyone else who may wish to impede or influence those proceedings in pursuit of their own ends.....

15. ...Parliament enjoys sole jurisdiction—normally described by the archaic term “exclusive cognisance”— over all matters subject to parliamentary privilege.....

17. A consequence of Parliament’s possession of exclusive cognisance over proceedings in Parliament is that participants, both Members and non-Members, are not legally liable for things said or done in the course of those proceedings; nor are those outside who are adversely affected by things said or done in Parliament able to seek redress through the courts.

18. Thus exclusive cognisance in certain circumstances may over-ride other generally accepted legal rights. It is, in effect, an exception to the general principle of the rule of law...”.

⁴KANADA. Cour Suprême du Canada, *New Brunswick Broadcasting Co. c. Nouvelle-Écosse (Président de l’Assemblée législative)*, (1993) 1 RCS 319, 1993 CanLII 153 (CSC).

36. Në nenet 73 dhe 75 të Kushtetutës, parashikohet se:

“Neni 73

1. Deputeti nuk mban përgjegjësi për mendimet e shprehura në Kuvend dhe votat e dhëna prej tij në ushtrim të funksionit. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastin e shpifjes.

2. Deputeti nuk mund të arrestohet ose t'i hiqet liria në çfarëdo lloj forme apo ndaj tij të ushtrohet kontroll personal ose i banesës, pa autorizimin e Kuvendit.....

Neni 75

1. Kuvendi zgjedh dhe shkarkon Kryetarin e vet.

2. Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas rregullores së miratuar nga shumica e të gjithë anëtarëve.”

37. Në thelb, e njëjta qasje dhe rregullim, si në qëllim ashtu edhe përmbajtje, gjendet edhe në dispozitat kushtetuese të shteteve të tjera demokratike, përfshirë edhe ato shtete ku padyshim ka lindur dhe është konsoliduar ndarja e pushteteve, demokracia parlamentare, shteti i së drejtës dhe liria parlamentare. Janë pikërisht këto përvoja e sisteme mbi të cilat duket se janë mbështetur tërësisht edhe parimet e normat e Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë të vitit 1998, si p.sh neni 26 i Kushtetutës franceze ⁵, nenet 40 dhe 46 të Ligjit Themeltar (Kushtetutës) Federal Gjerman ⁶, nenet 71 e 72 të Kushtetutës spanjolle ⁷, neni 1 seksioni 5 klauzola 2 dhe

CourSuprême du Canada, Canada (Chambre des communes) c. Vaid, (2005) 1 RCS 667, 2005 CSC 30

⁵ **Article 26** - *Aucun membre du Parlement ne peut être poursuivi, recherché, arrêté, détenu ou jugé à l'occasion des opinions ou votes émis par lui dans l'exercice de ses fonctions.*

Aucun membre du Parlement ne peut faire l'objet, en matière criminelle ou correctionnelle, d'une arrestation ou de toute autre mesure privative ou restrictive de liberté qu'avec l'autorisation du Bureau de l'assemblée dont il fait partie. Cette autorisation n'est pas requise en cas de crime ou délit flagrant ou de condamnation définitive.

La détention, les mesures privatives ou restrictives de liberté ou la poursuite d'un membre du Parlement sont suspendues pour la durée de la session si l'assemblée dont il fait partie le requiert.....

⁶ **Artikel 40** - *(1) Der Bundestag wählt seinen Präsidenten, dessen Stellvertreter und die Schriftführer. Er gibt sich eine Geschäftsordnung.*

(2) Der Präsident übt das Hausrecht und die Polizeigewalt im Gebäude des Bundestages aus. Ohne seine Genehmigung darf in den Räumen des Bundestages keine Durchsuchung oder Beschlagnahme stattfinden

Artikel 46 - *(1) Ein Abgeordneter darf zu keiner Zeit wegen seiner Abstimmung oder wegen einer Äußerung, die er im Bundestage oder in einem seiner Ausschüsse getan hat, gerichtlich oder dienstlich verfolgt oder sonst außerhalb des Bundestages zur Verantwortung gezogen werden. Dies gilt nicht für verleumderische Beleidigungen.*

(2) Wegen einer mit Strafe bedrohten Handlung darf ein Abgeordneter nur mit Genehmigung des Bundestages zur Verantwortung gezogen oder verhaftet werden, es sei denn, daß er bei Begehung der Tat oder im Laufe des folgenden Tages festgenommen wird.

(3) Die Genehmigung des Bundestages ist ferner bei jeder anderen Beschränkung der persönlichen Freiheit eines Abgeordneten oder zur Einleitung eines Verfahrens gegen einen Abgeordneten gemäß Artikel 18 erforderlich.....

⁷ **Artículo 71** - *1. Los Diputados y Senadores gozarán de inviolabilidad por las opiniones manifestadas en el ejercicio de sus funciones.*

2. Durante el periodo de su mandato los Diputados y Senadores gozarán asimismo de inmunidad y sólo podrán ser detenidos en caso de flagrante delito. No podrán ser inculcados ni procesados sin la previa autorización de la Cámara respectiva.....

Artículo 72 - *1. Las Cámaras establecen sus propios Reglamentos, aprueban autónomamente sus presupuestos y, de común acuerdo, regulan el Estatuto del Personal de las Cortes Generales. Los Reglamentos y su reforma serán sometidos a una votación final sobre su totalidad, que requerirá la mayoría absoluta.*

2. Las Cámaras eligen sus respectivos Presidentes y los demás miembros de sus Mesas. Las sesiones conjuntas serán presididas por el Presidente del Congreso y se regirán por un Reglamento de las Cortes Generales aprobado por mayoría absoluta de cada Cámara.

3. Los Presidentes de las Cámaras ejercen en nombre de las mismas todos los poderes administrativos y facultades de policía en el interior de sus respectivas sedes.

seksioni 6- klauzola 1 e Kushtetutës federale të SHBA ⁸, neni 64 dhe 68 të Kushtetutës italiane,⁹ etj.

38. Kështu, në harmoni e plotësim të parimeve dhe normave të tjera kushtetuese, neni 75 i Kushtetutës parashikon posaçërisht e në mënyrë të qartë se veprimtaria e Kuvendit, ku përfaqësohet, mëshirohet dhe shprehet më drejtpërdrejt sovraniteti popullor, rregullohet në mënyrë të pavarur prej vetë Kuvendit nëpërmjet rregullores së miratuar më shumicën e anëtarëve të tij. Kjo mënyrë unike e rregullimit të veprimtarisë së Kuvendit, si një zhvillim normativ i menjëhershëm që buron nga Kushtetuta, është edhe shprehje e garancive të posaçme të vendosura nga kjo Kushtetutë për garantimin e pavarësisë së Kuvendit nga ndërhyrjet në veprimtarinë e tij prej pushteteve të tjera dhe hallkave të tyre.

38.1 Sipas “*teorisë së akteve të parlamentit*” të zhvilluar nga jurisprudenca dhe Këshilli i Shtetit në Francë, por edhe në shtete të tjera perëndimore, së paku prej shekullit të XIX e deri më sot, pranohet se aktet normative dhe individuale që lidhen drejtpërdrejt me ushtrimin e funksioneve kushtetuese nga ana e parlamentit kanë imunitet juridiksional, pra nuk i nënshtrohen kontrollit gjyqësor nga gjykatat e zakonshme. ¹⁰

39. Ndërsa neni 73 i Kushtetutës, në lidhje me deputetët e Kuvendit, përcakton dy lloje garancish me të cilat synohet të garantohet veprimtaria, funksionimi dhe autoriteti i Kuvendit dhe e deputetëve duke i mbrojtur nga ndërhyrjet në veprimtarinë e tyre prej hallkave të pushtetit ekzekutiv dhe atij gjyqësor.

39.1 Dispozita e nenit 73 të Kushtetutës, në funksion të garantimit të pavarësisë së deputetit, *së pari*, garanton mungesën e përgjegjësisë së deputetëve lidhur me format e shfaqjes dhe përmbajtjen e qëndrimeve dhe të mendimeve të shprehura, si edhe votave të dhëna prej tyre gjatë veprimtarive parlamentare. *Së dyti*, garanton imunitetin e kufizuar procedural penal të deputetëve, veçanërisht në lidhje me masat e sigurimit dhe të kontrollit, për rastet kur deputeti i nënshtrohet procedimit penal.

40. Ekzistenca dhe dallimi ndërmjet këtyre dy llojeve të garancive kushtetuese evidentohet nga qëllimi dhe fusha e ndryshme e mbrojtjes së deputetit.

40.1 Kështu, garancia kushtetuese e mungesës së përgjegjësisë, qoftë penale apo civile, për sjelljet, veprimet, mendimet e shprehura dhe votat e dhëna gjatë veprimtarisë parlamentare, synon pikërisht që të garantojë ushtrimin e pavarur të funksioneve të deputetit duke mbrojtur

⁸Article 1 Section 6 Clause 2 - Each House may determine the rules of its proceedings, punish its members for disorderly behavior, and, with the concurrence of two thirds, expel a member.

Article 1 Section 5 Clause 1 - The Senators and Representatives shall receive a compensation for their services, to be ascertained by law, and paid out of the treasury of the United States. They shall in all cases, except treason, felony and breach of the peace, be privileged from arrest during their attendance at the session of their respective Houses, and in going to and returning from the same; and for any speech or debate in either House, they shall not be questioned in any other place.

⁹64. - Ciascuna Camera adotta il proprio regolamento a maggioranza assoluta dei suoi componenti.....

68. - I membri del Parlamento non possono essere chiamati a rispondere delle opinioni espresse e dei voti dati nell'esercizio delle loro funzioni.

Senza autorizzazione della Camera alla quale appartiene, nessun membro del Parlamento può essere sottoposto a perquisizione personale o domiciliare, né può essere arrestato o altrimenti privato della libertà personale, o mantenuto in detenzione, salvo che in esecuzione di una sentenza irrevocabile di condanna, ovvero se sia colto nell'atto di commettere un delitto per il quale è previsto l'arresto obbligatorio in flagranza.

Analoga autorizzazione è richiesta per sottoporre i membri del Parlamento ad intercettazioni, in qualsiasi forma, di conversazioni o comunicazioni e a sequestro di corrispondenza.

¹⁰FRANCË, Këshilli i Shtetit, (CE) Conseil d'Etat, Section, du 15 Novembre 1872, n° 45079, publié au recueil Carrey de Bellemare,;

“... Dhoma e Deputetëve është pjesë e atyre pushteteve në të cilin mëshirohet sovraniteti; ...me këtë pozitë aktet e saj, dhe mbi të gjitha Rregullorja e saj, e miratuar në seancë plenare, nuk mund t'i nënshtrohen kompetencës së gjykatave....”.

lirinë e tij të shprehjes dhe të mendimit. Kjo garanci kushtetuese është e përhershme dhe e mbron deputetin edhe në të ardhmen, pra shtrihet edhe pas mbarimit të mandatit të tij parlamentar.¹¹

40.2 Ndërsa imuniteti i kufizuar procedural penal, nuk përjashton përgjegjësinë e deputetit për sjelljet e tjera që nuk përfshihen në ushtrimin e veprimtarisë parlamentare të tij, por lidhet me nevojën e dhënies së autorizimit paraprak nga ana e Kuvendit veçanërisht në caktimin e masave të sigurimit që, për vetë natyrën e tyre, e kufizojnë ose heqin lirinë e deputetit nëse ai ndiqet penalisht. Po kështu, lidhet edhe me rastet e nevojës së kryerjes së veprimeve hetimore penale të kontrollit personal dhe të banesës së deputetit që i nënshtrohet ndjekjes penale. Kjo lloj garancie kushtetuese shtrihet dhe vepron vetëm gjatë periudhës kur deputeti ushtron mandatin e tij.¹²

41. Në këtë kuptim, edhe dispozitat e neneve 73 dhe 75 të Kushtetutës, në harmoni me parimet dhe normat e tjera kushtetuese, nuk synojnë që thjesht të krijojnë privilegje e të mbrojnë pozitën dhe interesat personale të deputetëve.

41.1 Nga njëra anë, këto garanci i shërbejnë forcimit të pavarësisë së pushtetit ligjvënës. Gjithashtu, ato shërbejnë si një nga mjetet për mirëfunksionimin e parimit të ndarjes së pushteteve të parashikuar nga neni 7 i Kushtetutës.

41.2 Nga ana tjetër, ato synojnë të garantojnë mbrojtjen e integritetit të vetë Kuvendit dhe të procesit legjislativ edhe nëpërmjet sigurimit të pavarësisë së secilit prej deputetëve të tij.¹³

42. Pra, Kuvendi nuk mund të përmbushë funksionet e tij, nëse deputetëve, secilit prej tyre, nuk u garantohet liria parlamentare dhe mungesa e pengesave në ushtrimin e detyrës, si edhe nëse Kuvendi si organ kushtetues nuk do të kishte kompetencat e duhura për të mbrojtur e garantuar autoritetin e tij dhe lirinë personale e parlamentare të deputetëve. Në këtë mënyrë mbrohen edhe të drejtat kushtetuese të zgjedhësve të cilët i kanë votuar deputetët për të përfaqësuar elektoratin në mënyrë të pavarur, pa pengesa e ndërhyrje nga pushtetet e tjera.

43. Në mënyrë të veçantë, garancia e mungesës së përgjegjësisë penale apo civile përpara ekzekutivit dhe gjykatave, lidhur me veprimet, mendimet e shprehura dhe votat e dhëna gjatë veprimtarisë parlamentare, është një garanci që vepron edhe në situatat kur deputeti tejkalon apo

¹¹GJERMANI, Vendimi i Gjykatës Federale Kushtetuese, [Bundesverfassungsgericht](#)(BVerwG), Beschluss vom 17. September 2013 - 2 BvR 2436/10 2 BvE 8/08:

“.....në kuptim të nenit 46, paragrafi 1 të Ligjit Themeltar, deputeti nuk mund ti nënshtrohet ndjekjes përpara gjykatave ose sanksioneve disiplinore ose të thirret në mënyrë tjetër për të dhënë llogari jashtë Bundestag-ut”. Kjo dispozitë duhet të interpretohet në mënyrë të zgjeruar në dritën e interpretimit literal dhe të ratio të saj, si një garanci për veprimtarinë dhe funksionimin e parlamentit dhe të deputetëve (cfr. BVerfGE 104, 310, 332).....”.

- Shiko edhe vendimin e Gjykatës Federale Kushtetuese (BVerwG): Beschluss vom 23.04.1985 – 2 WD 42.84 (BVerwGE: 83, 1/15) ;

¹ - Shiko edhe Footnote 15 më poshtë.

¹²SPANJË, Vendim i Gjykatës Kushtetuese, Tribunal Constitucional, S.T.C. 90/1985, de 22 de julio (Caso "SUPPLICATORIO DEL SENADOR BARRAL"):

“.....imuniteti përbën një prerogativë të karakterit formal, i cili synon të garantojë Dhomat dhe funksionimin e tyre, dukë evituar sulmet politike dhe të instrumentalizuara ndaj përfaqësuesve të popullit; pra nuk ka natyrën e një privilegji personal të individit dhe duhet të interpretohet në këtë mënyrë të ngushtuar. Në përfundim të mandatit të tij si parlamentar ai i kthehet nënshtimit para ligjit nga gjykatat e zakonshme”.

- Shiko edhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese, Tribunal Constitucional STC 243/1988, 9/1990 dhe 206/1992.

GJERMANI, Vendim i Gjykatës Federale Kushtetuese, [Bundesverfassungsgericht](#)(BVerwG), BVerfGE 104, 310/332
Vendim i Gjykatës Federale të Drejtësisë, [Bundesgerichtshof](#) (BGH), BGHSt 20, 248/250 ; BGHSt 104, 310/326.

¹³MBRETËRIA E BASHKUAR (UK), Vendimi Gjykatës Supreme, [Supreme Court of the United Kingdom](#) (UKSC), R v Chaytor, 2010, UKSC 52:

“.....Privilegji parlamentar nuk mbron interesin individual të secilit parlamentar, por atë të Houses si organe kolektive. Prandaj, parlamentarët nuk nënshtrohen juridiksionit penal dhe civil për aktet e kryer në kontekstin e procedurave parlamentare....”.

e përdor në mënyrë të papërshtatshme lirinë e tij parlamentare të mëshiruar në rregullat parlamentare.

43.1 Kjo garanci gjen zbatim nëse përmbushen dy kushte thelbësore. *Së pari*, kjo të ketë ndodhur “në ushtrim të funksionit”, pra gjatë veprimtarisë së tyre parlamentare dhe, *së dyti*, me kushtin që nga një sjellje e tillë të mos jenë shkaktuar pasoja të tjera të rënda sipas ligjit penal. Në çdo rast, deputeti nuk mund të kërkojë mbrojtje nëpërmjet kësaj garancie për raste të sjelljeve e veprimeve që nuk lidhen me ushtrimin e funksionit të deputetit dhe shfaqjet e lirisë parlamentare të tij.

43.2 Ky interpretim dhe zbatim korrekt i normës kushtetuese është i konsoliduar dhe gjen mbështetje parimore edhe në të gjithë drejtësinë kushtetuese të shteteve perëndimore të cilat i kanë miratuar dhe zbatuar norma të kësaj natyre.¹⁴

43.3 Në rastin e kushtit të parë, i përket vetë Kuvendit, juridiksioni ekskluziv për të shqyrtuar dhe gjykuar nëse jemi ose jo përpara ushtrimit të rregullt apo abuzimit, pra nëse kanë ndodhur ose jo shkelje e tejkalime të të drejtave dhe garancive që Kushtetuta dhe Rregullorja i njej deputetit “në ushtrim të funksionit”, pra gjatë veprimtarisë parlamentare. Nëse vlerëson se kemi të bëjmë me sjellje e veprime që nuk kanë lidhje me ushtrimin e funksionit parlamentar të deputetit apo kemi të bëjmë me shkelje dhe tejkalime të garancisë kushtetuese të lirisë parlamentare në ushtrimin e këtij funksioni, Kuvendi vendos ndëshkimin disiplinor të deputetit duke zbatuar masat disiplinore që ai çmon të përshtatshme.

43.4 Pas zhvillimit dhe përfundimit të procedurave verifikuese, hetimore dhe gjyqesore, organet përkatëse të vetë Kuvendit përcaktojnë nëse deputeti mban apo jo përgjegjësi disiplinore sipas dispozitave kushtetuese dhe atyre të Rregullores. Në vijim, në varësi të përfundimeve të arritura për shkeljen ose jo të rregullave parlamentare me anë të fjalës, sjelljes dhe veprimit të tij, organet e Kuvendit vendosin të ndëshkojnë ose jo disiplinarisht deputetin. Pas ushtrimit të juridiksionit disiplinor të Kuvendit, për të njëjtin fakt dhe subjekt, në asnjë rast dhe në çdo kohë, pra edhe në të ardhmen, askush nuk ka të drejtën të kërkojë dhe asnjë organ tjetër nuk ka juridiksionin të shqyrtojë një çështje civile apo penale, në ngarkim të deputetit.¹⁵¹⁶

¹⁴P.sh. nëSHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS (USA), Gjykata e Lartë është shprehur se Neni 1, Seksioni 5, Klauzola 1 nuk janë konceptuar asnjëherë si një rregull që synon “të mbrojtë të gjitha sjelljet në procesin legjislativ”. Korrupsioni “nuk është, në asnjë lloj interpretimi, një veprim që kryhet si pjesë e funksionit të një ligjvënësi”, prandaj nuk mund të gëzojnë asnjë mbrojtje nga kjo Klauzolë. Interpretimet dhe vendimet e Gjykatës së Lartë në rastet e lidhura me Nenin 1 Seksioni 5 Klauzola 1 (Klauzola e Fjalës dhe Debatit) shprehen për nevojën për tu garantuar parlamentarëve mbrojtjen absolute lidhur me shprehjen e mendimeve dhe qëndrimeve gjatë debatit parlamentar (1), propozimit dhe votimit të projekt-akteve (2), në përgatitjen dhe parashtrimin e argumentave në komisione parlamentare (3), në veprimet e kryera dhe nismat e marra gjatë seancave plenare dhe në komisione (4)(5) etj. Nga ana tjetër, kjo Klauzolë kushtetuese nuk garanton veprime e veprimtari të cilat rastësisht ose në mënyrë incidentale lidhen a ndodhin me veprimtarinë legjislativë dhe detyrimet parlamentare të deputetit, por që nuk bëjnë pjesë në procesin legjislativ dhe veprimtarinë parlamentare (6). P.sh deklaratimet dhe fjalimet e mbajtura jashtë Kongresit, përgatitja dhe shpërndarja e deklaratave të shtypit (6), përgatitja dhe publikimi i botimeve dhe librave mbi veprimtarinë parlamentare (7), publikimi dhe shpërndarja e relacioneve dhe materialeve të komisioneve parlamentare jashtë ambienteve të Kongresit (8) etj. Këto veprime nuk gëzojnë mbrojtje parlamentare ndonëse janë kryer si pjesë e punës së deputetit ose senatorit. “Ndonëse janë veprimtari të ligjshme, ato kanë natyrë politike dhe jo legjislativë dhe, si të tilla, nuk mund të mbulohen nga garancia e Klauzolës”(9). (1)Johnson, cit., Gravel, cit. (2)Powell v. MacCormack, 395 U.S. 486, del 1969; Kilbourn, cit.; Fletcher v. Peck, 10 U.S. - 6 Cranch 87, del 1810. (3)Doe v. McMillan, 412 U.S. 306 (del 1973), Kilbourn, cit. (4)McMillan, cit., Gravel, cit. (5)Eastland, cit. (6)Brewster, cit. (7)Gravel, cit. (8) McMillan, cit., Brewster, cit. (9)Ibid.

¹⁵FRANCË, X. PRETOT, *Les collaborateurs des parlementaires et le droit du travail, Droit Social*, 1986, 431:

Mungesa e përgjegjësisë mbron parlamentarën në lidhje me aktet dhe veprimet e kryera në kuadër të mandatit të tij, mbrojtje e cila është absolute dhe e përhershme, me synimin e mbrojtjes së lirisë së shprehjes dhe të vendimmarrjes së të zgjedhurit. Ndërsa aktet dhe veprimet e jashtme (të kryera në cilësinë e personit privat apo jashtë ambienteve të Parlamentit) i nënshtrohen së drejtës së zakonshme.

¹⁶FRANCË, Këshilli i Shtetit, (CE) *Conseil d'Etat, Section, du 9 juin 1978, 05911, publié au recueil Lebon: Veprimet e quajtura “të tepruara”, pra sjelljet e parlamentarëve që prishin rëndë zhvillimin e veprimtarive parlamentare, janë në kompetencën ekskluzive të Asamblesë përkatëse (neni 70 i Rregullores së Asamblesë Kombëtare, neni 92 i Rregullores së Senatit). Masat disiplinore..... mund të ankimohen përpara gjyqararit administrativ, i cili gjykon vetëm nëse ka pasur një gabim të dukshëm në vlerësimin e çështjes.....”.*

43.5 Në rastin e kushtit të dytë, pra kur fakti që ka ndodhur nuk lidhet me ushtrimin e funksionit të deputetit dhe me shfaqjen e lirisë parlamentare të tij apo kur pavarësisht se fakti ka ndodhur në Kuvend ose edhe gjatë veprimtarisë parlamentare por nga ky fakt kanë ardhur pasoja të rënda sipas ligjit penal, atëherë, sipas rastit, deputeti i nënshtrohet përgjegjësisë përkatëse civile ose penale. Në këto raste Kuvendi nuk investohet me procedim disiplinor kundrejt tij. Kuvendi mund të investohet vetëm nëse, sipas Kushtetutës dhe ligjit penal, shqyrton kërkesën e organit procedues për ndjekjen penale, për dhënien e autorizimit për zbatimin e masave të sigurimit apo kryerjen e veprimeve të kontrollit personal a të banesës së deputetit të proceduar penalisht.¹⁷

43.6 Ky kuptim dhe interpretim i garancive kushtetuese mbi mungesën e përgjegjësisë civile a penale për veprimet, mendimet e shprehura dhe votat e dhëna gjatë veprimtarisë parlamentare, si edhe mbi imunitetin procedural penal në rastet kur deputeti i nënshtrohet ndjekjes penale, rezulton të jetë në thelb i njëjtë dhe pajtohet me ato të trajtuara nga praktika gjyqësore kushtetuese edhe në shtetet e tjera me sistem demokratik, histori dhe parlamentarizëm të zhvilluar, praktika e qëndrime të cilat për aspekte të ndryshme janë cituar më sipër dhe do të citohen në vijim në këtë vendim.¹⁸

44. Kolegji Penal vëren se, në pajtim dhe në zhvillim të drejtpërdrejtë të parimeve dhe dispozitave kushtetuese, pushteti ligjvënës, i mëshiruar tek Kuvendi i Shqipërisë, ka normuar në mënyrë të pavarur veprimtarinë e tij nëpërmjet “Rregullores së Kuvendit”. Kjo Rregullore është miratuar më shumicën e anëtarëve të Kuvendit, me vendimin e tij nr.166 datë 16.12.2004, i ndryshuar. Njëkohësisht, norma të rëndësishme parimore për garantimin dhe forcimin e autonomisë së pushtetit ligjvënës, si edhe mbi të drejtat e detyrimit e deputetëve, parashikohen me ligjin nr.8550/1999 “Statusi i deputetëve”.¹⁹

45. Rregullorja e Kuvendit është një nga aktet dhe shprehjet më të rëndësishme të jetësimin të parimit themeltar kushtetues të autonomisë së Kuvendit. Parashikimi i shprehur i

¹⁷KANADA, (a) CHAMBRE DES COMMUNES (Canada), *Application du privilège parlementaire aux députés à titre individuel*, in *Compendium – Procédure en ligne*, <http://www.parl.gc.ca>. (b) A. O'BRIEN – M. BOSC, *La procédure et les usages de la Chambre des communes*, cit., e J. P. MAINGOT, *Le privilège parlementaire au Canada*, cit., 40, 42, 45-48, 93-97 :

(a) Deklarimet e parlamentarëve janë të mbrojtura nga privilegji kur janë bërë gjatë punimeve parlamentare, por nuk janë vetvetiu të mbrojtura kur ato përsëriten në rrethana e vende të tjera, si p.sh nëpërmjet deklaratave të shtypit, dërgimit postar apo me anë të faqeve të internetit, në një intervistë televizive ose radiofonike, në një takim publik ose ambientin e parlamentarit të zonës së tij zgjedhore. As edhe parashtrimet e bëra nga deputeti gjatë një takimi në të cilën ai merr pjesë në cilësinë e përfaqësuesit të zgjedhur, por jo brenda ambienteve të Parlamentit, vështrirë se mund të mbrohen nëpërmjet këtij privilegji, madje as edhe në rastin e citimeve të fjalës që parlamentari ka mbajtur gjatë punimeve parlamentare.

(b) Në këto raste, përhapja e dokumenteve të vlerësuar p.sh si shpifëse, nuk mund të mbrohet me privilegjin të lirisë së fjalës.

¹⁸SHBA, Gjykata e Lartë. *US Supreme Court, United States v. Johnson, 383 U.S. 169, del 1966 ; US Supreme Court, United States v. Brewster, 408 U.S. 501, del 1972*

KANADA, Gjykata e Lartë. *Cour Suprême du Canada, New Brunswick Broadcasting Co. c. Nouvelle-Écosse (Président de l'Assemblée législative)*, (1993) 1 RCS 319, 1993 CanLII 153 (CSC).

¹⁹Ligji nr.8550/1999 “Statusi i deputetit”:

Neni 2 - 1. Deputeti i Kuvendit gëzon status të veçantë gjatë periudhës së ushtrimit të mandatit të deputetit, status që buron nga Kushtetuta dhe nga ligjet.

2. Me status të deputetit kuptohet pozicioni që ka ai në marrëdhëniet juridike, në marrëdhëniet me organet administrative shtetërore dhe organet e qeverisjes vendore, si dhe të drejtat dhe detyrimet financiare dhe protokollare.

Neni 4 - 1. Deputeti merr pjesë rregullisht në seanca plenare, në komisione si dhe në të gjithë veprimtarinë e Kuvendit, në përputhje me kërkesat e Rregullores së Kuvendit.

2. Deputeti ka të drejtë të ushtrojë vetë dhe në kuadrin e veprimtarisë së komisionit kontrollin e zbatimit të ligjeve, vendimeve e akteve të tjera të nxjerra nga Kuvendi, nga Këshilli i Ministrave, nga ministrinë, nga organet e qeverisjes vendore dhe institucionet e tjera qendrore.

3. Deputeti ka të drejtë të shprehë lirish mendimet e tij dhe të zgjedhësve që ai përfaqëson, nëpërmjet diskutimeve, propozimeve, debatit, interpelancave dhe pyetjeve, mocioneve, deklaratave dhe votës.

këtij akti normativ nga vetë dispozita e pikës 2 të nenit 75 të Kushtetutës, i jep kësaj Rregulloreje autoritetin e plotë ligjor për vetërregullimin e garantuar të veprimtarisë parlamentare në të gjitha aspektet e saj, edhe si një mjet që e garanton pushtetin ligjvënës nga çdo ndikim dhe ndërhyrje e papërshtatshme e pushteteve dhe organeve të tjera, pikërisht në veprimtarinë e Kuvendit.

46. Kjo Rregullore parashikon organizimin dhe funksionimin e Kuvendit, procedurën ligjvënëse, procedurat e ushtrimit të kontrollit mbi organet dhe institucionet shtetërore, transparencën e veprimtarisë së Kuvendit, procedurat për emërimin, zgjedhjen dhe shkarkimin e organeve të caktuara, çështjet e interpretimit dhe të ndryshimit të Rregullores dhe për heqjen e imunitetit të deputetëve, si edhe çështjet lidhur me shërbimet për Kuvendin.

47. Në veçanti, në pjesën e parë të Rregullores, parashikohen edhe normat materiale e procedurale që dispijlojnë të drejtat dhe detyrimet e deputetëve, përfshirë ato mbi respektimin e rregullit dhe të sjelljes që duhet të ndjekin e të shfaqin deputetët gjatë veprimtarisë parlamentare, llojet e shkeljeve dhe masat disiplinore përkatëse, si edhe procedurat e kompetencat e Kryetarit, Byrosë dhe të vetë Kuvendit në shqyrtimin dhe vendimmarrjen për raste të tilla.

48. Kështu, ndërmjet të tjerave, në Rregulloren e Kuvendit parashikohet sa vijon:

“Neni 7 - Kryetari i Kuvendit

1. *Kryetari i Kuvendit përfaqëson Kuvendin, siguron respektimin e të drejtave të Kuvendit dhe të anëtarëve të tij. Ai kujdeset për zhvillimin e veprimtarisë parlamentare, në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit.....*

2. *Në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, Kryetari u jep fjalën deputetëve, drejton dhe moderon në mënyrë të paanshme debatet, siguron rendin në seancë plenare.....*

Neni 11 - Thirrja dhe kompetencat e Byrosë së Kuvendit

.....5. *Byroja e Kuvendit shqyrton dhe vendos për masat disiplinore të propozuara nga drejtuesi i seancës, sipas nenit 65 pika 2 të kësaj Rregulloreje.*

Neni 40 - Veprimtaria parlamentare

1. *Deputetët janë në veprimtari parlamentare kur ata marrin pjesë në seancë plenare dhe në mbledhjet e komisioneve ose të këshillave;..... , si dhe kur janë në mbledhjet e grupeve parlamentare ose në grupe të ndryshme pune të ngritura nga Kuvendi ose nga komisionet e Kuvendit.....*

3. *Anëtarët e Kuvendit, gjatë veprimtarisë së tyre, zbatojnë Kodin e Sjelljes.*

Neni 62 - Rregulli dhe sjellja në Kuvend

1. *Anëtarët e Kuvendit nuk duhet të ndërpresin fjalën e drejtuesit të seancës plenare ose të diskutuesve të tjerë, të përdorin gjuhë ofenduese dhe joparlamentare në Kuvend, të ndërmarrin sulme personale apo veprime ndaj ndonjë deputeti, të përhapin informacione që cenojnë jetën private të cilitdo, të sillen në mënyrë të padenjë ose të shkaktojnë rrëmujë në mjediset e Kuvendit.*

Neni 64 - Masa disiplinore e tërheqjes së vëmendjes dhe vërejtjes

1. Kur deputetithotë fjalë të pahijshme, pengon me sjelljen e tij zhvillimin e seancës plenare ose cenon rregullin e saj, i tërhiqet vëmendja nga drejtuesi i seancës plenare.....

3. Kur deputeti e përsërit shkëljen në të njëjtën seancë plenare....., ose deputeti që cenon seriozisht rendin në seancë plenare i jepet vërejtje nga drejtuesi i seancës.

5. Kur deputeti pengon zhvillimin e rregullt të seancës, nëpërmjet zaptimit të foltores dhe moslejimit të deputetit të radhës të marrë fjalën, për më shumë se 2 minuta, atëherë Kryetari i Kuvendit i tërheq vërejtjen dhe e paralajmëron për marrjen e masës së përjashtimit në rast vazhdimi.

Në rast se deputeti vazhdon të mbajë të zaptuar foltoren edhe pas tërheqjes së vërejtjes....., përjashtohet nga seanca plenare dhe komisionet me maksimumin e parashikuar në nenin 65 të Rregullores

Neni 65 - Masat disiplinore më të rënda

1. **Kur deputeti përdor fjalë fyese ose cenon personalitetin e drejtuesit të seancës.....**, me urdhër të drejtuesit të seancës, përjashtohet nga seanca plenare për atë ditë. Në rast se deputeti s'pranon të dalë nga salla, drejtuesi i seancës e ndërpret atë dhe i jep porosinë e nevojshme Shërbimit të Sigurisë në Kuvend për zbatimin e urdhrin të dhënë. Masa disiplinore e përjashtimit nga seanca plenare shoqërohet me sanksion financiar të barabartë me një ditë nga paga e deputetit.

2. **Kur deputeti bën thirrje për përdorim dhune, provokon rrëmujë në seancë që pengon zhvillimin e saj të rregullt, fyen ose kërcënon deputetët e tjerë, anëtarët e Këshillit të Ministrave ose përdor fjalë fyese për Presidentin e Republikës apo institucione të tjera shtetërore ndalohet të marrë pjesë në punimet e Kuvendit në seancë plenare dhe në komisione deri në 10 ditë.**

Ndalimi i pjesëmarrjes vendoset nga Byroja e Kuvendit me propozimin e drejtuesit të seancës deputeti, ndaj të cilit kërkohet marrja e masës disiplinore, ka të drejtë të marrë pjesë në të për të paraqitur qëndrimin e tij.

Masa disiplinore e ndalimit të pjesëmarrjes në seancë plenare dhe në komisione shoqërohet me sanksion financiar të mbajtjes së pagës së deputetit për aq ditë sa është marrë masa disiplinore.....

3. **Për ngjarje tepër të rënda që ndodhin jashtë sallës ku zhvillohen punimet e Kuvendit, por brenda mjediseve të tij, Kryetari i Kuvendit merr masën disiplinore të parashikuar në pikën 2 të këtij neni.**”

49. Dispozitat e Rregullores mbajnë parasysh se Shqipëria është republikë parlamentare (neni 1 i Kushtetutës), e bazuar në shtetin e së drejtës (neni 4), ndarjen dhe balancimin e tre pushteteve shtetërore (neni 7), duke vendosur në një pozitë kushtetuese krejt të posaçme autoritetin dhe pavarësinë e Kuvendit në përmbushjen e misionit të tij (neni 74) si edhe të deputetëve në ushtrimin e funksionit parlamentar (neni 73).

50. Sikurse qartë konstatohet edhe në rastin e parashikimeve mbi parimet dhe normat kushtetuese të cituara në pikën 37 të këtij vendimi, Kolegji Penal vëren se, edhe në çështjet mbi rregullat e organizimit dhe të funksionimit të parlamenteve, mbështetur në të njëjtat qëllime dhe arsye, Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë përmban dhe shpreh të njëjtën frymë dhe parime kushtetuese, madje përmban edhe rregullime identike ose thelbësisht të njëjta me ato të akteve rregullatorë të parlamenteve të shteteve perëndimore të cilat kanë sisteme, histori e traditë të konsoliduar kushtetuese dhe, posaçërisht, në fushën e parlamentarizmit.

50.1 Prandaj, për efekte krahasuese juridike, të natyrës normuese dhe interpretuese, gjithnjë në funksion të zgjidhjes së drejtë të çështjes objekt i këtij gjykimi, lidhur me

interpretimin dhe zbatimin e parimeve e të normave përkatëse të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, veçanërisht të neneve 7, 11, 13, 40, 62-65 të saj, është vendi të mbahen parasysh parimet dhe rregullat e akteve parlamentare të disa prej këtyre shteteve, si p.sh nga Mbretëria e Bashkuar ²⁰, Franca ²¹, SHBA ²², Gjermania ²³, Kanadaja ²⁴, Italia²⁵, Spanja ²⁶, Holanda ²⁷ etj..

51. Kolegji Penal vëren se, pavarësisht nga dallimet joparimore që natyrshëm mund të gjenden në formulimin e tyre, qartësisht mund të konstatohet që, në thelb, ekziston një përputhshmëri parimore dhe rregullatore në sistemin e rregullave që janë miratuar dhe zbatohen në Kuvendin e Shqipërisë dhe atyre të parlamenteve të shteteve të tjera të sipërcituara për sa i përket:

a. autonomisë së parlamentit në vetërregullimin e çështjeve të ndryshme të veprimtarisë së tij dhe burimit kushtetues të këtij vetërregullimi,

b. kuptimit, qëllimit dhe natyrës së papërgjegjshmërisë dhe lirisë parlamentare,

c. natyrës dhe llojeve të shkeljeve nga ana e deputetëve, të cilat e cenojnë autoritetin e parlamentit dhe pavarësinë e deputetëve të tjerë,

ç. natyrës së sanksioneve disiplinore dhe përshkallëzimit të zbatimit të tyre,

d. ushtrimit nga vetë organet e parlamentit të kompetencave të hetimit, gjykimit dhe ndëshkimit disiplinor të deputetit,

dh. ndalimit të organeve të juridiksioneve të tjera, përfshirë gjykatat e zakonshme, për tu investuar në mënyrë fillestare apo rishikuese, si lidhur me përmbajtjen e rregullave parlamentare, ashtu edhe lidhur me zbatimin e tyre në procedurën e ndjekur dhe në masat e mara nga organet përkatëse të parlamentit ndaj deputetit që kryen shkelje disiplinore.

52. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së dispozitave të sipërcituara të Rregullores së Kuvendit, në veçanti të neneve 40, 62, 65/3, njësoj si dispozitat e akteve normuese parlamentare të shteteve të lartpërmendura perëndimore, Kolegji Penal vlerëson se ato parashikojnë qartë dhe në ndonjë aspekt edhe hollësisht parimet, kuptimin dhe rregullat e funksionimit të Kuvendit, si edhe subjektet, hapësirën (mjediset) dhe natyrën e veprimtarive parlamentare (“*në ushtrim të funksionit*” të deputetit – neni 73 i Kushtetutës) ku shtrihet veprimi i kësaj Rregulloreje.

52.1 Dispozitat e sipërcituara të Rregullores (përfshirë nenin 7) përcaktojnë se *subjekte të të drejtave dhe detyrimeve* që burojnë prej saj janë sjelljet dhe qëndrimet e deputetëve të Kuvendit, por nuk përjashtohen edhe ato të personave që janë thirrur për deklarime ose shpjegime apo të atyre në radhët e publikut.

52.2 Autoriteti i Kuvendit dhe organeve të tij, për respektimin e dispozitave të Rregullores dhe të garancive e detyrimeve që burojnë prej saj dhe Kushtetutës, gjejnë zbatim si për veprimtaritë parlamentare, ashtu edhe për sjelljet dhe veprimet e deputetëve apo të ftuarve *në të gjitha ambientet e Kuvendit*, pra jo vetëm në sallat ku zhvillohet veprimtaria parlamentare por edhe në mjediset e tjera brenda “*mureve*” të Kuvendit (neni 7, 62, 64, 65).

52.3 Parime dhe parashikime të njëjta gjejmë edhe në aktet rregullatorë të parlamenteve të tjera. Kështu, për sa i përket shtrirjes së autoritetit ekskluziv të Kuvendit dhe Rregullores së tij

²⁰ *Standing Orders of the House of Commons, Public Business (2015), Order in the House, Standing Order no. 42-46*

²¹ *Règlement de l'Assemblée Nationale, Janvier 2015, Chapitre XIV "Discipline, immunité et déontologie", Article 70-73,77.*

²² *Rules of the House of Representatives, One Hundred Fourteenth Congress (2015), Rule I (Clauses 2-3), Rule IV, Rule IX Questions of Privilege, Rule XI (Clause 1-2), Rule XVII Decorum and Debate (Clauses 4-5), Rule XXIII Code of Official Conduct (Clauses 1-6).*

²³ *Geschäftsordnung des Deutschen Bundestages, § 7 (1, 2), § 13, § 18, § 36- § 41.*

²⁴ *Standing Orders of the House of Commons, January 2014, Chapter II, Standing Orders 15-23.*

²⁵ *Regolamento della Camera dei Deputati, Art. 8, 39, 58-62.*

²⁶ *Reglamento del Congreso de Los Diputados, Artículo 102- 107.*

²⁷ *Reglement van Orde van de Tweede Kamer der Staten-Generaal, Artikel 57-62.*

sipas *parimit të hapësirës*, ndërmjet atyre që citohen në pikën 51 të këtij vendimi, p.sh mund të evidentojmë *Rregullin 1 Pika 2 dhe 3 të Rregullores së Dhomës së Përfaqësuesve (Kongresit) të SHBA* ku, në thelb, parashikohet se Kryetari siguron rregullin dhe sjelljen në të gjitha ambientet e Kongresit.²⁸

52.4 Po kështu, edhe *Rregullin 105 dhe 106 të Rregullores së Kongresit të Deputetëve në Spanjë* ku, në thelb, parashikohet se Kryetari garanton ruajtjen e rregullit në hapësirën e Kongresit dhe në të gjitha ambientet e tij. Po aty parashikohet se çdo person, përfshirë edhe anëtarët e Kongresit, të cilët brenda ambienteve parlamentare shkaktojnë turbullira serioze me sjelljet dhe veprimet e tyre, do ti nënshtrohen masave disiplinore përfshirë dëbimin e të ftuarit apo përjashtimin e deputetit nga punimet dhe ambientet e Kongresit për një periudhë një mujore.²⁹³⁰

52.5 Për sa i përket shtrirjes së autoritetit dhe garancive të parashikuara në Rregulloren e Kuvendit sipas *parimit të veprimtarisë parlamentare*, edhe pse në aktet rregullatore parlamentare të disa prej shteteve të tjera e që citohen në pikën 51 të këtij vendimi nuk gjen dispozitë të posaçme që përcakton llojet dhe kufijtë e veprimtarive parlamentare, e për të cilat vepron garancia kushtetuese e mungesës së përgjegjësisë së deputetit, veprimi i këtij parimi është i qartë nga tërësia e rregullave që përcaktojnë mënyrën se si parlamentet përkatëse ushtrojnë veprimtarinë e tyre, si edhe nga praktika gjyqësore e konsoliduar për këtë qëllim.

52.6 Sipas nenit 40 të Rregullores së Kuvendit, këto rregulla janë të zbatueshme për deputetët kur ata marrin pjesë në *veprimtaritë e ndryshme parlamentare* të cilat janë seancat plenare, mbledhjet e komisioneve ose të këshillave, mbledhjet e grupeve parlamentare, pjesëmarrja në grupe të ndryshme pune të ngritura nga Kuvendi ose nga komisionet e Kuvendit.

52.7 Nga ana tjetër, mund të evidentojmë se, në parim, parashikim i njëjtë me atë të nenit 73 të Kushtetutës sonë (“*1. Deputeti nuk mban përgjegjësi për mendimet e shprehura në Kuvend dhe votat e dhëna prej tij në ushtrim të funksionit...*”), lidhur me nocionin e veprimtarisë parlamentare dhe ushtrimit të funksionit parlamentar i gjejmë edhe në Kushtetuta të tjera si p.sh neni 46 i Kushtetutës gjermane, neni 68 i Kushtetutës italiane, neni 9 i “*Bill of Rights*” të vitit 1689 në Mbretërinë e Bashkuar, neni 26 i Kushtetutës franceze, Neni 1 Seksioni 6 Klauzola 1 e Kushtetutës së SHBA etj.

²⁸SHBA. *Rules of the House of Representatives, One Hundred Fourteenth Congress (2015), Rule 1 (Clauses 2-3).*

Clause 2. (Preservation of order) The Speaker shall preserve order and decorum and, in case of disturbance or disorderly conduct in the galleries or in the lobby, may cause the same to be cleared.

Clause 3. (Control of Capitol facilities) Except as otherwise provided by rule or law, the Speaker shall have general control of the Hall of the House, the corridors and passages in the part of the Capitol assigned to the use of the House, and the disposal of unappropriated rooms in that part of the Capitol.

²⁹SPANJA. *Reglamento del Congreso de Los Diputados (official English translation)*

Section 105 - In the exercise of disciplinary authority under Section 72.3 of the Constitution, the Speaker shall ensure maintenance of order within the precincts of the House and in all its premises, to which end he may adopt all such measures as he sees fit, including the committing to the courts of any persons disturbing such order.

Section 106 - Any person who, within the parliamentary precincts, in or outside a meeting, and whether or not a Member of Congress, arouses a serious disturbance by his conduct in word or deed, shall be immediately expelled. If he is a member, the Speaker shall in addition suspend him immediately from his status as such for a term of up to one month, and the House may, upon the proposal of the Bureau and in accordance with the provisions of Section 101, resolve to extend or increase the penalty.

³⁰MBRETËRIA E BASHKUAR (UK). Joint Committee On Parliamentary Privilege, *Parliamentary Privilege, First Report, 1999*, Chapter 5: Control by Parliament over its affairs

“229. Parliamentary freedom of speech guaranteed by article 9 is one facet of the broader principle that what happens within Parliament is a matter for control by Parliament alone. Such matters will not be reviewed by the courts.(264) In a recent case the judicial committee of the Privy Council summed up the position:

“So far as the courts are concerned, they will not allow any challenge to be made to what is said or done within the walls of Parliament in performance of its legislative functions and protection of its established privileges.(265)

This principle is usually known as ‘exclusive cognisance’: cognisance here bears its obsolete legal meaning of jurisdiction, or the right to deal with a matter judicially.(266).....”

52.8 Në të gjitha rastet e cituara në paragrafin më sipër, nuk përmbahen përcaktime konkrete apo të qarta lidhur me selinë dhe vendet e ushtrimit të mandatit parlamentar. Përgjithësisht këto norma shprehen për fjalën, shprehjen e mendimit, qëndrimet dhe sjelljen e parlamentarëve “*në parlament*”. Me të njëjtën qasje, lidhur me mungesën e përgjegjësisë për mendimet e shprehura dhe votat e dhëna në parlament, interpretimi i këtyre dispozitave nga parlamentet dhe praktikat gjyqësore, bëhet përgjithësisht në mënyrë të ngushtuar sipas kriterit *intra moenia*. Pra, në parim, për të gjitha llojet e veprimtarive parlamentare, kjo garanci kushtetuese gjen zbatim brenda “kufijve” të selive dhe ambienteve ku ushtron veprimtarinë e tij Parlamenti.³¹

52.9 Krahas parimit të vendit (*ratione loci*) ku ushtrohet veprimtaria e parlamentarit, element tjetër i rëndësishëm për të vlerësuar nëse gjen zbatim ose jo garancia kushtetuese e parashikuar nga neni 73 i Kushtetutës dhe dispozitat e Rregullores së Kuvendit të miratuar në përputhje me të, është edhe *parimi i lidhjes funksionale* të veprimeve, shprehjeve dhe qëndrimeve konkrete të deputetit me funksionin dhe veprimtarinë e tij parlamentare, veçanërisht në rastet kur ato kanë ndodhur jashtë selisë dhe ambienteve të Kuvendit (*extra moenia*).

52.10 Nga njëra anë, kryerja nga deputeti gjatë veprimtarisë parlamentare të sjelljeve dhe deklarimeve të ndaluara sipas Rregullores së Kuvendit, ndonëse ato mund të jenë bërë në parlament (*intra moenia*), sjellin përgjegjësinë disiplinore të deputetit, pavarësisht që nëse do të ndodhnin jashtë Kuvendit dhe veprimtarive parlamentare shkelje të tilla i nënshtrohen përgjegjësisë civile, madje edhe asaj penale. Verifikimi, shqyrtimi dhe ndëshkimi disiplinor i këtyre shkeljeve është ekskluzivisht në juridiksionin e Kuvendit. Megjithatë, deputeti përgjigjet penalisht në rastet kur kryen sjellje të tilla që linden përgjegjësinë penale dhe që nuk kanë lidhje funksionale me ushtrimin e mandatit të deputetit në veprimtarinë parlamentare, si edhe në rastet kur nga sjelljet e ndaluara të deputetit kanë ardhur pasoja të rënda të ndëshkueshme penalisht.

52.11 Nga ana tjetër, njëlloj si subjektet e tjerë, deputeti mban përgjegjësi, e cila mund të jetë edhe civile ose penale, nëse sjelljet dhe deklaramet e tij e që sjellin përkatësisht përgjegjësi civile apo penale, kanë ndodhur jashtë “*mureve*” të Kuvendit (*extra moenia*), aq më tepër nëse këto sjellje dhe deklarime nuk kanë lidhje ushtrimin e funksionit të deputetit. Verifikimi, shqyrtimi dhe ndëshkimi eventual i këtyre rasteve është në juridiksionin e gjykatave.

52.12 Gjithashtu, në rastet që i paraqiten për verifikim dhe vendimmarrje, është thelbësore që, nga Kuvendi ose gjykata, të verifikohet paraprakisht nëse deputeti është shprehur dhe ka vepruar si i tillë apo si thjesht si një politikan ose si çdo shtetas tjetër. Pra, duhet të verifikohet nëse deklaramet dhe veprimet e kryera jashtë ambienteve ku Kuvendi ushtron funksionet e tij janë shprehje e ushtrimit të veprimtarive (funksionit) parlamentare të parashikuara nga Kushtetuta dhe Rregullorja e Kuvendit.

52.13 Prandaj, në mënyrë që një deputet të gëzojë mbrojtjen e garancisë kushtetuese të mungesës së përgjegjësisë sipas nenit 73 të Kushtetutës, ai duhet të jetë duke e ushtruar funksionin e tij parlamentar (“*acte détachable*”), pra të mos jetë duke vepruar apo shprehur si politikan ose si një person që shpreh mendimin dhe qëndrimin e tij për një çështje të caktuar, për shkak se, jashtë përmbushjes së funksionit parlamentar, për këto veprime dhe shprehje deputeti i nënshtrohet ligjit sikurse subjektet e tjerë.

52.14 Duke pasur parasysh që, sikurse arsyetohet më sipër në këtë vendim, parimet dhe normat tona kushtetuese dhe rregullatore parlamentare janë në thelb të njëjta me ato të shteteve të tjera demokratike, është e rëndësishme të evidentohet se, të njëjtën interpretim juridik e

³¹GJERMANI : 2 BVR 2436/10, 2 BVE 8/08, BGHZ 75, 384, 387. SHBA :*Kilbourn v. Thompson*, 103 U.S. 168, 26 L. Ed. 377 (1880); *Powell v. MacCormack*, 395 U.S. 486 (1969); *Gravel v. United States*, 408 U.S. 606, 608-609 (1972); *Doe v. McMillan*, 412 U.S. 306 (1973); *Dennis v. Sparks*, 449 U.S. 24, 30 (1980). MBRETËRIA E BASHKUAR : *Joint Committee on Parliamentary Privilege, Parliamentary Privilege, First Report, 1999*, par. 37; *Wilson v. First County Trust Ltd (No 2)* (2003) ; UKHL 40, *Prebble v. Television New Zealand* (1995) AC 321, *Pepper v. Hart* (1992) UKHL 3.

mbizotërues të kësaj natyre, lidhur me kufijtë e zbatimit të garancisë kushtetuese të mungesës së përgjegjësisë për sjelljet e kryera dhe mendimet e shprehura nga deputeti, e gjejmë në dokumentet parlamentare dhe praktikën gjyqësore të shteteve të tjera.³²

53. Gjithashtu, duke pasur të njëjtën frymë e parime kushtetuese dhe në thelb parime rregullatore të njëjta me aktet përkatëse që rregullojnë veprimtarinë dhe funksionimin e parlamenteve të shteteve perëndimore, edhe dispozitat e Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë (si p.sh nenet 62, 64 e 65) përmbajnë parashikime mbi llojet e sjelljeve të ndaluara të deputetëve që ata mund të kryejnë në mjedise të Kuvendit apo gjatë veprimtarive parlamentare e në lidhje me këto veprimtari, për të cilat Kuvendi ka juridiksionin ekskluziv për ti verifikuar dhe ndëshkuar disiplinarisht.

53.1 Sjelljet dhe veprimet e ndaluara të deputetëve në mjedise të Kuvendit apo gjatë veprimtarive parlamentare shfaqen e kryhen me anë të fjalëve, shprehjeve e gjesteve fyese, shpifëse, penguese apo kërcënuese, si edhe me anë të veprimeve të tjera materiale, përfshirë ato penguese, kërcënuese e të dhunshme, të cilat e cenojnë rregullin, zhvillimin normal të veprimtarive dhe autoritetin e Kuvendit, si edhe cenojnë realizimin e të drejtave të deputetëve në ushtrimin e funksionit kushtetues të tyre.

53.2 Kështu, mes të tjerave, në nenin 62 të Rregullores së Kuvendit si shprehje, sjellje dhe veprime të ndëshkueshme disiplinarisht prej Kuvendit parashikohen rastet kur deputetët “*ndërpresin fjalën e drejtuesit të seancës plenare ose të diskutuesve të tjerë*”, “*përdorin gjuhë ofenduese dhe joparlamentare*”, “*ndërmarrin sulme personale apo veprime ndaj ndonjë deputeti*”, “*përhapin informacione që cenojnë jetën private të cilitdo*”, “*sillen në mënyrë të padenjë ose të shkaktojnë rrëmujë në mjediset e Kuvendit*”.

53.3 Në vijim të nenit 62, llojet e shkeljeve që cenojnë autoritetin e Kuvendit dhe të deputetëve të tij zgjerohen apo përcaktohen edhe më hollësisht në dispozitat e neneve 64 dhe 65 të Rregullores ku përmenden “*fjalët e pahijshme*”, “*pengimi i zhvillimit të seancës plenare*”, “*zaptimi i foltores dhe moslejimi i deputetit të radhës të marrë fjalën*”, “*përdorimi i fjalëve fyese ose cenimi i personalitetit të drejtuesit të seancës*”, “*thirrjet për përdorim dhune*”, “*provokimi i rrëmujës në seancë që pengon zhvillimin e saj të rregullt*”, “*fyerja ose kërcënimi i deputetëve dhe personaliteteve të tjerë*”, “*ngjarjet tepër të rënda që ndodhin jashtë sallës ku zhvillohen punimet e Kuvendit, por brenda mjediseve të ti që i nënshtrohen ndëshkimit disiplinor nga Kuvendi*”.

53.4 Këto kategori a lloje shkeljesh dhe tejkalimesh të lirisë parlamentare nga ana e deputetëve, të parashikuara nga Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë, gjenden të parashikuara shprehimisht edhe në dispozitat rregullatore të funksionimit të parlamenteve në mjaft shtete të tjera demokratike.³³

³²ITALIA, Gjykata Kushtetuese. *Corte Costituzionale, Sentenza no. 137/2001; no. 270/2002; no. 249/2006; no. 1/2013; no. 55/2014; no. 221/2014.*

MBRETËRIA E BASHKUAR (UK), Joint Committee On Parliamentary Privilege, *Parliamentary Privilege, First Report, 1999*, Chapter 2: Freedom of speech and Article 9 of the Bill of Rights

FRANCË, Gjykata e Kasacionit. *Cour de Cassation, Chambre criminelle, du 7 mars 1988, 87-80.931; Cour de Cassation, Chambre criminelle, du 16 Decembre 1997, 96-82509; Cour de Cassation, Chambre criminelle, du 12 Novembre 2008, 07-83398.*

³³ITALIA, Regolamento della Camera dei Deputati

53.5 Krahas këtyre parashikimeve rregullatore normative, në interpretim apo në plotësim të tyre, në shtetet e tjera demokratike, natyra dhe llojet e tejkalimit dhe të shkeljeve të lirisë parlamentare, të ndëshkueshme disiplinarisht dhe ekskluzivisht nga vetë parlamenti, janë interpretuar dhe pranuar vazhdimisht nga praktika parlamentare, si edhe nga praktika gjyqësore kushtetuese ose administrative e tyre. Kjo praktikë dhe jurisprudencë është dinamike, në pasurim dhe ndryshim të vazhdueshëm.³⁴

53.6 Në Mbretërinë e Bashkuar, parlamenti ushtron autoritetin ndaj deputetëve dhe të tretëve që ndodhen në ambientet e tij, për të mos lejuar apo për të garantuar ndëshkimin e tyre, nëse me shprehjet dhe veprimet e kryera cenojnë ushtrimin e funksioneve të parlamentit, shkelje kjo e kualifikuar si “*contempt of Parliament*”.

53.6.1 Kjo kategori shkeljesh (“*contempt*”) nuk rregullohet në mënyrë të hollësishme nga normat juridike, por të dy Dhomat e parlamentit (*House of Commons* dhe *House of Lords*) kanë të drejtën ekskluzive të vlerësojnë dhe gjykojnë rast pas rasti nëse është vendi për zbatimin e saj dhe ndëshkimin e parlamentarit përgjegjës. Praktika shumë e pasur parlamentare kualifikon si shkelje të kategorisë “*contempt of Parliament*” nga ana e deputetëve, mes të tjerash, edhe pengimin ose prishjen e zhvillimit normal të procedurave parlamentare, kërcënimin ose veprimet

*ART. 59*1. *Se un deputato pronunzia parole sconvenienti oppure turba col suo contegno la libertà delle discussioni o l'ordine della seduta, il Presidente lo richiama nominandolo...*

ART. 60 1..... *il Presidente può disporre l'esclusione dall'Aula per il resto della seduta, se un deputato ingiuria uno o più colleghi o membri del Governo.*

3. *Il Presidente della Camera può altresì proporre all'Ufficio di Presidenza la censura con interdizione di partecipare ai lavori parlamentari.... se un deputato fa appello alla violenza, o provoca tumulti, o trascorre a minacce o a vie di fatto verso qualsiasi collega o membro del Governo, o usa espressioni ingiuriose nei confronti delle istituzioni o del Capo dello Stato....*

4. *Per fatti di eccezionale gravità che si svolgano nella sede della Camera, ma fuori dell'Aula, il Presidente della Camera può proporre all'Ufficio di Presidenza le sanzioni previste nel comma 3.*

FRANCË, Règlement de l'Assemblée Nationale, Janvier 2015, Chapitre XIV “Discipline, immunité et déontologie”

Article 70 *Peut faire l'objet de peines disciplinaires tout membre de l'Assemblée :*

1° *Qui se livre à des manifestations troublant l'ordre ou qui provoque une scène tumultueuse ;*

2° *Qui se livre à une mise en cause personnelle, qui interpelle un autre député ou qui adresse à un ou plusieurs de ses collègues des injures, provocations ou menaces ;*

3° *Qui a fait appel à la violence en séance publique ;*

4° *Qui s'est rendu coupable d'outrages ou de provocations envers l'Assemblée ou son Président ;*

5° *Qui s'est rendu coupable d'injures, de provocations ou de menaces envers le Président de la République, le Premier ministre, les membres du Gouvernement et les assemblées prévues par la Constitution ;*

6° *Qui s'est rendu coupable d'une voie de fait dans l'enceinte de l'Assemblée ;*

7° *À l'encontre duquel le Bureau a conclu, en application de l'article 80-4, à un manquement aux règles définies dans le code de déontologie.*

HOLLANDË, Reglement van Orde van de Tweede Kamer der Staten-Generaal (official English translation)

Section 58. *Warning; withdrawal of words*

1. *If a person who has the floor strays from the subject of debate, the President shall call on him to return to the subject in hand.*

2. *If a member or a Minister uses offensive language, causes a disturbance, violates his duty of secrecy as referred to in chapter XIA, fails to observe confidentiality as referred to in chapter XIIB or signifies his approval of or incites the commission of unlawful acts, he shall be reprimanded by the President and given the opportunity to withdraw the words that have given rise to the warning.*

Section 59. *Order to yield the floor*

1. *If a person who has the floor makes no use of the opportunity referred to in section 58, paragraph 2, or continues to stray from the subject of debate, to use offensive language, to cause a disturbance, to violate his duty of secrecy as referred to in chapter XIA, to fail to observe confidentiality as referred to in chapter XIIB or to signify his approval or incite the commission of unlawful acts, the President may order him to yield the floor.....*

Section 60. *Exclusion from a meeting*

The President may exclude a member addressing the meeting to whom section 59 has been applied and any other member who has been guilty of acts of the kind referred to in that section from further attendance at the meeting on the day on which the exclusion occurs.

³⁴MBRETËRIA E BASHKUAR (UK), Joint Committee on Parliamentary Privilege, Parliamentary Privilege, Report of Session 2013–14 :
“13. *Parliamentary privilege is a living concept, and still serves to protect Parliament, each House, their committees, and all those involved in proceedings. Much has changed since the publication of the report of the 1999 Joint Committee: privilege evolves as Parliament evolves, and as the law evolves....*

47. *...The extent of Parliament's exclusive cognisance changes over time, as the work of Parliament evolves: it would be impracticable and undesirable to attempt to draw up an exhaustive list of those matters subject to exclusive cognisance...”.*

e dhunshme, mosrespektimin e urdhrave dhe të vendimeve të nxjerra rregullisht nga organet përkatëse të parlamentit, mosparaqitja përpara një komisioni parlamentar kur kjo është e detyrueshme, etj.³⁵

53.7 Në Francë, praktika parlamentare dhe gjyqësore, e cituar më sipër në këtë vendim, ka pranuar se deputeti nuk gëzon mbrojtjen sipas garancisë kushtetuese të mungesës së përgjegjësisë për mendimet dhe votimin në parlament (neni 26 paragrafi i parë i Kushtetutës franceze), në rastet e deklarimeve dhe veprimeve të kryera prej tij që nuk lidhen drejtpërdrejt me ushtrimin e funksionit parlamentar, të tilla si fjalimet dhe diskutimet në takime a mbledhje publike ose private, botimi i artikujve dhe opinioneve në median e shkruar dhe elektronike, intervista të dhëna në programe televizive apo radiofonike etj.

53.8 Edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Dhoma e Përfaqësuesve (*House of Representatives*) dhe Senati (*Senate*) ushtrojnë autoritetin e tyre ndaj deputetëve dhe të tretëve që ndodhen në ambientet e parlamentit për të mos lejuar apo për të garantuar ndëshkimin e tyre nëse ata me shprehjet dhe veprimet e kryera cenojnë ushtrimin normal të funksioneve të parlamentit.

53.8.1 Ky autoritet ushtrohet në rastet e shkeljes së garancive (privilegjeve) që Kushtetuta amerikane i njej parlamentit dhe anëtarëve të tij, të cilat grupohen në dy kategori privilegjesh (garancish). E para garanton të drejtat e parlamentit kolektivisht, autoritetin, dinjitetin, integritetin dhe sigurinë e tij gjatë veprimtarisë parlamentare. E dyta garanton autoritetin, reputacionin, të drejtat dhe sjelljen e anëtarëve të parlamentit individualisht.

53.8.2 Rregullat parlamentare, praktika disiplinore parlamentare dhe ajo gjyqësore amerikane kanë identifikuar si shkelje të privilegjeve kushtetuese, mes të tjerash, përdorimin e gjuhës dhe shprehjeve fyese dhe joparlamentare, veprimet e dhunshme kundrejt një anëtari të parlamentit, cenimin e dinjitetit të parlamentit me anë të paraqitjes së rezolutave fyese, mosbashkëpunimin dhe abuzimin me veprimtarinë e komiteteve parlamentare, veprimet e tjera të çdo lloji që cenojnë autoritetin, reputacionin dhe besimin tek parlamenti etj.³⁶

³⁵MBRETËRIA E BASHKUAR (UK),Parliamentary Privilege, First Report, 1999:

“ Contempt of Parliament”

264. *Contempts comprise any conduct (including words) which improperly interferes, or is intended or likely improperly to interfere, with the performance by either House of its functions, or the performance by a member or officer of the House of his duties as a member or officer. (300) The scope of contempt is broad, because the actions which may obstruct a House or one of its committees in the performance of their functions are diverse in character. Each House has the exclusive right to judge whether conduct amounts to improper interference and hence contempt. The categories of conduct constituting contempt are not closed. The following is a list of some types of contempt:*

- interrupting or disturbing the proceedings of, or engaging in other misconduct in the presence of, the House or a committee
- assaulting, threatening, obstructing or intimidating a member or officer of the House in the discharge of the member's or officer's duty
- deliberately attempting to mislead the House or a committee (by way of statement, evidence, or petition)
- deliberately publishing a false or misleading report of the proceedings of a House or a committee
- removing, without authority, papers belonging to the House
- falsifying or altering any papers belonging to the House or formally submitted to a committee of the House
- deliberately altering, suppressing, concealing or destroying a paper required to be produced for the House or a committee
- without reasonable excuse, failing to attend before the House or a committee after being summoned to do so
- without reasonable excuse, refusing to answer a question or provide information or produce papers formally required by the House or a committee
- without reasonable excuse, disobeying a lawful order of the House or a committee
- interfering with or obstructing a person who is carrying out a lawful order of the House or a committee
- bribing or attempting to bribe a member to influence the member's conduct in respect of proceedings of the House or a committee
- intimidating, preventing or hindering a witness from giving evidence or giving evidence in full to the House or a committee
- bribing or attempting to bribe a witness
- assaulting, threatening or disadvantaging a member, or a former member, on account of the member's conduct in Parliament
- divulging or publishing the content of any report or evidence of a select committee before it has been reported to the House.

Additionally, in the case of members:

- accepting a bribe intended to influence a member's conduct in respect of proceedings of the House or a committee
- acting in breach of any orders of the House
- failing to fulfil any requirement of the House, as declared in a code of conduct or otherwise, relating to the possession, declaration, or registration of financial interests or participation in debate or other proceedings.(301) “

³⁶SHBA.H.Rept. 27, 90th Cong., 1st Sess., at 24-26, 29 (1967);

Gjykata Supreme, Supreme Court *Powell v. McCormack* 395 U.S. 486 (1969);

53.9 Në Republikën Federale të Gjermanisë, neni 46 i Kushtetutës e mbron deputetin lidhur me mendimet e shprehura dhe format e shfaqjes së qëndrimeve të tij në veprimtarinë parlamentare, pra si shfaqjen (përcjelljen) publike të qëndrimeve faktike ashtu edhe të opinioneve, deklarimeve të vullnetit, mendimeve me shkrim dhe me gojë, madje edhe të veprimeve konkludente, të kryera në funksion të ushtrimit të mandatit të deputetit.

53.9.1 Por, nga ana tjetër, kjo garanci kushtetuese nuk e mbron deputetin dhe ai është përgjegjës disiplinarisht, civilisht apo penalisht në raste të tilla si:

a. debatet dhe grindjet më natyrë private mes deputetëve në parlament (pra sjellje të tilla që nuk kanë lidhje me ushtrimin e këtij mandati);

b. si rregull, për shfaqjen e opinioneve e deklarimeve të ndryshme jashtë parlamentit (*Bundestag*) dhe komisioneve të tij;

c. në veçanti, për shfaqjen e opinioneve dhe deklarimeve që kategorizohen të natyrës së veprimtarisë politike, sikurse janë ato të bëra në udhëtime zyrtare, në takime, mbledhje e manifestime publike, partiake ose elektorale; nëpërmjet botimeve, intervistave dhe programeve të ndryshme mediatike.

53.9.2 Megjithatë, në rastin e fundit të cituar në paragrafin më sipër (c), deputeti mund të mbrohet nga garancia kushtetuese e mungesës së përgjegjësisë kur ai me anë të deklaratave të shtypit, me mjete të komunikimit elektronik apo në media ose në takime e aktivitete të ndryshme publike citon në “*original*”, pra rigorozisht, sikurse rezulton në procesverbalin e seancës plenare ose të komisionit parlamentar, përmbajtjen e deklarimeve dhe të opinioneve të shprehura, me gojë apo shkrim, në punimet e parlamentit nga vetë deputeti ose nga parlamentarë të tjerë.³⁷

54. Po kështu, me të njëjtën qasje parimore kushtetuese e rregullatore me shtete të tjera demokratike³⁸, Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë, veçanërisht në nenet 7, 11, 64 dhe 65, parashikon edhe norma materiale lidhur me llojet e masave disiplinore dhe sanksionet financiare që zbatohen ndaj deputetëve, proporcionalisht me natyrën, rëndësinë dhe pasojat e ardhura nga shkeljet e Rregullores, si edhe normat procedurale lidhur me kompetencat dhe procedurën që zbatojnë organet e Kuvendit për verifikimin, shqyrtimin dhe eventualisht ndëshkimin disiplinor e financiar të sjelljeve, fjalëve dhe veprimeve të deputetëve e që kualifikohen si shkelje dhe tejkalim i ushtrimit të rregullt të funksionit të deputetit.

54.1 Sipas nenit 7 të Rregullores së Kuvendit, është në kompetencën e Kryetarit që të sigurojë “... *respektimin e të drejtave të Kuvendit dhe të anëtarëve të tij*” të kujdeset “*për zhvillimin e veprimtarisë parlamentare, në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit*” dhe të sigurojë “*rendin në seancë plenare*”.

54.2 Kuvendi ka juridiksionin ekskluziv të shqyrtimit dhe ndëshkimit disiplinor të rasteve kur deputetët, me anë të fjalës, sjelljeve dhe veprimeve të tyre cenojnë autoritetin e Kuvendit dhe ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të deputetëve të tjerë. Pra, nëse anëtarët e Kuvendit nuk

House Committee on Standards of Official Conduct, “Historical Summary of Conduct Cases in the House of Representatives” (November 2004); House of Representatives Exclusion, Censure and Expulsion Case from 1789 to 1973;

[Congressional Research Service](#). *Expulsion, Censure, Reprimand, and Fine: Legislative Discipline in the House of Representatives*, Jack Maskell, Legislative Attorney, May 2, 2013.

³⁷GJERMANI. Vendim i Gjykatës Federale Kushtetuese, *Bundesverfassungsgericht (BVerwG)*, “Beschluss vom 23. 04. 1985 - 2 WD 42. 84” (BVerfGE 29, 125)

Vendim i Gjykatës Federale të Drejtësisë, *Bundesgerichtshof (BGH)*, “Beschluss vom 18.12.1979 – vi zr 240/78” (BGHZ 75, 384/387)

Revista e Re Juridike, *Neue Juristische Wochenschrift (NJW)* 1980, 780, 781;

³⁸Mund të konsultohen Rregulloret parlamentare të disa shteteve perëndimore në **Footnote 20-27** më sipër.

respektojnë Kodin e Sjelljes, pengojnë zhvillimin normal të punimeve, cenojnë rendin dhe sigurinë në seancën plenare, madje edhe në ambientet e Kuvendit, duke kryer edhe sjellje a veprime si ato të parashikuara në nenin 62 të Rregullores, atëherë Kryetari i Kuvendit ka autoritetin dhe kompetencën të disiplinojë Kuvendin dhe anëtarët e tij, duke dhënë ndaj tyre masën disiplinore të tërheqjes së vëmendjes, të vërejtjes, paralajmërimit për marrjen e masës së përjashtimit dhe përjashtimit nga seanca (neni 64). Ndërsa shqyrtimi dhe dhënia e masës disiplinore të përjashtimit nga seancat plenare dhe komisionet apo ajo e ndalimit të pjesëmarrjes në to për një afat në maksimum deri në 10 ditë, vendoset nga Byroja e Kuvendit me propozimin e drejtuesit të seancës (neni 65).

55. Prandaj, nisur nga sa arsyetohet më sipër në këtë vendim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të Kushtetutës, nga ku buron në mënyrë të shprehur e të drejtpërdrejtë autoriteti unik normativ i kësaj Rregulloreje dhe efektet e saj, Kolegjit Penal i rezulton se bëjnë pjesë në juridiksionin ekskluziv të vetë Kuvendit, të gjitha çështjet dhe veprimet për konstatimin, shqyrtimin, gjykimin dhe vendimmarrjen lidhur me sjelljet, fjalët, mendimet, qëndrimet ose gjestet fyese, shpifëse, penguese apo kërcënuese, sikurse edhe me veprimet materiale penguese, kërcënuese a të dhunshme të deputetëve, të cilat e cenojnë autoritetin e Kuvendit dhe që cenojnë e pengojnë ushtrimin e pavarur të funksionit të deputetit.

56. Gjithashtu, në respektim të ndarjes së pushteteve, pozitës kushtetuese që ka vetë pushteti ligjvënës dhe domosdoshmërisë së garantimit të mosndërhyrjes së pushteteve të tjera në veprimtarinë parlamentare dhe autonominë e Kuvendit, është vetë ky i fundit që, ekskluzivisht, i përcakton vetë rregullat e funksionimit të tij, përfshirë edhe ato që lidhen me garantimin e papërgjegjshmërisë - pra të mungesës së përgjegjësisë "*për mendimet e shprehura në Kuvend dhe votat e dhëna prej tij në ushtrim të funksionit*" (neni 73 i Kushtetutës).

57. Njëkohësisht, është vetë Kuvendi që i përcakton rregullat e nevojshme, materiale e procedurale mbi mënyrën, procedurën dhe strukturat përkatëse të tij të ngarkuara me kompetenca për hetimin, gjykimin dhe ndëshkimin disiplinor të deputetit që tejkalon lirinë parlamentare dhe shkel Rregulloren e Kuvendit, duke cenuar autoritetin e Kuvendit dhe lirinë e ushtrimit të rregullt të mandatit të deputetëve të tjerë.

58. Kolegji Penal vlerëson se është e rëndësishme të evidentohet që, në rastet e shkeljes së parimeve dhe normave të sipërtrajtuara kushtetuese e rregullatore mbi lirinë parlamentare të deputetëve dhe autoritetin e Kuvendit, si dhe në rastin e cenimit të garancive mbi mungesën e përgjegjësisë "*për mendimet e shprehura në Kuvend dhe votat e dhëna prej tij në ushtrim të funksionit*" (neni 73 i Kushtetutës) të kryera nëpërmjet fjalës, gjesteve dhe veprimeve të tjera materiale, qoftë edhe me natyrë fyese, shpifëse, penguese, kërcënuese dhe të dhunshme, si edhe të garancive mbi autonominë dhe autoritetin e Kuvendit, interesat dhe marrëdhëniet juridike të mbrojtura e që cenohen prej këtyre veprave janë të drejtat e deputetit, ushtrimi i mandatit të tij, liria parlamentare e mendimit, fjalës dhe votës, sikurse edhe autoriteti e funksionimi i Kuvendit.³⁹

59. Këto sjellje e vepra të deputetëve, të kryera në ambientet e Kuvendit dhe gjatë veprimtarive parlamentare e në lidhje me to, ndëshkohen disiplinarisht nga Kuvendi, pikërisht për shkak të cenimit të të drejtave të deputetëve të tjerë në cilësinë e tyre si funksionarë kushtetues, në thelb, për shkak të cenimit të ushtrimit të lirë të funksionit prej tyre - ushtrimit të lirisë parlamentare të mendimit, fjalës dhe të votës.

³⁹KANADA, House of Commons Procedure and Practice, Second Edition, 2009, Parliamentary Privilege: A Definition, <http://www.parl.gc.ca/procedure-book-livre/Document.aspx?sbid=ABBC077A-6DD8-4FBE-A29A-3F73554E63AA&sbid=3027CC67-388E-4958-860C-C03FD3182BE3&Language=E&Mode=1>

- Cour Suprême du Canada, *New Brunswick Broadcasting Co. c. Nouvelle-Écosse (Président de l'Assemblée législative)*, (1993) 1 RCS 319, 1993 CanLII 153 (CSC).

59.1 Prandaj, për aq kohë sa nuk verifikohet dhe provohet, paraprakisht, nga vetë Kuvendi apo edhe gjykatat se *kanë ardhur pasoja të tjera të rënda të dënueshme sipas ligjit penal* ose për aq sa verifikohet dhe provohet se debati me elementë fyes/shpifës, i shoqëruar me sjellje të pahijshme, kërcënuese a veprime materiale të dhunshme mes deputetëve *kanë ndodhur për motive e çështje që nuk lidhen* me deklaratimet, qëndrimet e votimet në veprimtaritë parlamentare dhe pozicionet e mbajtura nga deputetët në ushtrimin e mandatit të tyre, pavarësisht nga ekzistenca në dukje e disa elementëve të natyrës (anës) objektive, deputeti i cenuar nuk mund të mbrohet duke u bazuar në veprat penale të parashikuara nga Kodi Penal.⁴⁰

60. Në këtë kuptim, asnjë organ i pushteteve të tjera shtetërore, përfshirë edhe gjykatat, nuk kanë juridiksion fillestar për të hetuar, gjykuar dhe ndëshkuar *sjelljet, shprehjet dhe veprimet e deputetëve në veprimtaritë parlamentare e që përbëjnë* shkelje të Rregullores së Kuvendit. Asnjë organ i pushteteve të tjera shtetërore, përfshirë edhe gjykatat, nuk mund të hetojë dhe gjykojë çështje për të njëjtin fakt e që përbën shkelje disiplinore sipas Rregullores së Kuvendit, aq më tepër kur për këtë fakt ka gjykuar dhe është shprehur vetë Kuvendi duke e kualifikuar dhe ndëshkuar si shkelje të tillë. Edhe lidhur me vlerësimin që ka bërë vetë Kuvendi, për t'u investuar ose jo lidhur për hetimin dhe gjykimin e tyre, si edhe për masat përkatëse disiplinore që ai eventualisht merr për rastet e shkeljeve disiplinore, deputeti i ndëshkuar apo ai që pretendon se është cenuar, nuk mund t'i drejtohet me padi apo ankim juridiksionit të zakonshëm gjyqësor.⁴¹

61. Nga ana tjetër, në interpretim dhe zbatim të parimeve të shtetit të së drejtës, të proporcionalitetit dhe të shkallëzimit së të drejtave të njeriut e lirive themelore që garantohen dhe mbrohen nga Kushtetuta e ligji, Kolegji Penal vlerëson se është e rëndësishme të mbahet parasysh që, nëse si pasojë e këtyre sjelljeve e veprave të deputetit në hapësirën e Kuvendit dhe gjatë veprimtarive parlamentare të tij, deputetit të dëmtuar i cenohet p.sh edhe jeta e shëndeti, atëherë marrëdhënia prioritare juridike e mbrojtur për këtë qëllim, rast pas rasti dhe sipas rrethanave konkrete të faktit, është jeta dhe shëndeti, sipas parashikimeve përkatëse të ligjit penal. Në këtë rast deputeti autor i veprës i nënshtrohet ligjit penal.

62. Po kështu, ligjit penal i nënshtrohet deputeti edhe për kryerjen e veprave të tjera, të cilat parashikohen nga ligji si vepër penale, të kryera qoftë edhe brenda ambienteve të Kuvendit dhe gjatë veprimtarive parlamentare, por që nuk janë forma të shfaqjes, me anë të fjalës ose veprimeve materiale, të mendimit e qëndrimit të tij apo të reagimit ose kundërshtimit ndaj fjalëve, qëndrimeve dhe veprimeve të bëra nga deputetët e tjerë, si p.sh veprat e natyrës korruptive, të abuzimit me detyrën etj.

⁴⁰— Si p.sh më kërkesën/akuzën për kryerjen e një kundërvajtjeje penale të “fjalës” apo asaj të rrahjes e veprimeve të tjera të dhunshme, kundërshtimit apo goditjes për shkak të detyrës të parashikuara nga nenet 90, 119, 120, 235, 237. të Kodit Penal

— Për efekte krahasimore, figura të veprave penale të kësaj natyre janë të parashikuara edhe nga ligji penal i shteteve të tjera demokratike. P.sh në Spanjë nenet 147/1, 210-215, 550-556 të Kodit Penal; në Francë nenet 222-11, 222-13, 223-13, 433-5 të Kodit Penal; në Itali nenet 337, 341 dhe 581 të Kodit Penal; në Gjermani nenet 113, 186, 187, 190, 223 të Kodit Penal.

— *Mund të konsultohen, mes të tjerash, edhe Footnote 13, 16, 31, 34, 35 më sipër.*

⁴¹KANADA. Gjykata Supreme e Kanadasë, *Cour Suprême du Canada, New Brunswick Broadcasting Co. c. Nouvelle-Écosse (Président de l'Assemblée législative)*, (1993) 1 RCS 319, 1993 CanLII 153 (CSC):

“.....Gjykatat mund të vlerësojnë dhe përcaktojnë nëse privilegji parlamentar pretenduar është i nevojshëm në mënyrë që organet legjislative të jenë në gjendje të funksionojë, por ato nuk kanë kompetencë të vlerësojnë nëse një vendim i caktuar parlamentaridhënë bazuarnë privilegjin është ose jo i drejtë....”.. Gjykata Supreme e Kanadasë, *Cour Suprême du Canada, Canada (Chambre des communes) c. Vaid*, 2005 CSC 30 (<http://scc-csc.lexum.com/decisia-scc-csc/scc-csc/ft/item/2231/index.do>)

“Gjykatat mund të shprehin lidhur me ekzistencën dhe mundësinë e zbatueshmërisë së privilegjeve në një rast konkret, por përderisa privilegjet i përkasin nivelit kushtetues, gjyqtarët e zakonshëm nuk mund të vendosin lidhur me modalitetet e ushtrimit të një privilegji, as edhe nuk mund të disponojnë mbi një çështje që i përket sferës së një privilegji. I përket ekskluzivisht dhomave të parlamentit çdo lloj vendimi lidhur me trajtimin dhe përdorimin e një privilegji parlamentar....”.

63. Prandaj, Kolegji Penal vlerëson të evidentojë se ligji penal nuk ka si objekt dhe nuk i parashikon si marrëdhënie juridike të mbrojtura posaçërisht prej tij çështjet e respektimit të disiplinës në veprimtarinë e Kuvendit, pra as edhe ato lidhur me respektimin e rregullit në ambientet e Kuvendit dhe të normalitetit në veprimtarinë parlamentare, si edhe as ato lidhur me sjelljen e deputetëve në ambientet e tij dhe në ushtrimin e funksionit gjatë veprimtarive parlamentare, mënyrën dhe formën e shfaqjes së lirisë parlamentare nga deputetët, mjetet me të cilat garantohet kjo liri parlamentare dhe autoriteti i Kuvendit. Rregullimi i këtyre çështjeve dhe autoriteti për të garantuar respektimin e tyre është ekskluzivisht i Kuvendit.

64. Nëse do të pranohej e kundërta, atëherë ushtrimi i juridiksionit nga pushtetet e tjera, pra edhe nga gjykata, do të përbënte ndërhyrje të këtyre pushteteve dhe organeve në ushtrimin e pushtetit ligjvënës, në veprimtarinë parlamentare dhe në ushtrimin e funksionit të deputetit. Për shkak të një ndërhyrjeje të tillë, Kuvendi dhe deputetët nuk do të ndjeheshin autonomë e të pavarur, por të penguar dhe nën presionin e përballjes me ndjekjen dhe ndëshkimin administrativ, civil ose penal, nga ekzekutivi e gjykatat, pikërisht për shkak të fjalës, mendimeve, gjesteve dhe veprimeve të tyre në ushtrimin e pushtetit ligjvënës dhe të funksionit të deputetit. Asnjë organ tjetër jashtë pushtetit ligjvënës, nuk ka dhe nuk duhet të lejohet të ushtrojë juridiksionin e saj për të gjykuar lidhur me mënyrën e ushtrimit të funksionit kushtetues të deputetit dhe të veprimtarisë parlamentare.⁴²

65. Nisur nga arsyetimi i parashtruar më sipër në këtë vendim lidhur me ligjin e zbatueshëm dhe interpretimin e drejtë të tij në rrethanat e faktit që kanë rezultuar të vërtetuara nga gjykimi, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se bazuar në paragrafin e parë të nenit 387 të Kodit të Procedurës Penale, çështja nuk duhet të fillonte për shkak se nuk bën pjesë në juridiksionin gjyqësor penal.

66. Sikurse pranohen te vërtetuara rrethanat e faktit në fillim të pjesës arsyetuese të këtij vendimi, nga gjykimi i çështjes rezultoi se, bazuar në kallëzimin e bërë nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike në datën 14.07.2014, Prokuroria e Përgjithshme ka regjistruar procedimin penal nr.01 të vitit 2014 dhe, pasi ka përfunduar hetimet paraprake, ka sjellë për gjykim para Gjykatës së Lartë të pandehurit Arben Ndoka dhe Pjerin Ndreu, deputetë të Kuvendit, të akuzuar për veprën penale të goditjes për shkak të detyrës të të dëmtuarit Gent Strazimiri, deputet i Kuvendit, parashikuar nga neni 237 i Kodit Penal.

67. Nga gjykimi rezultoi i provuar këto fakte të cilat kanë rëndësi thelbësore për zgjidhjen e drejtë të çështjes :

⁴²SPANJË. Vendim i Gjykatës Kushtetuese, *Tribunal Constitucional, S.T.C. 30/1997, de 24 febrero (Caso "Rodriguez Ibarra ")*:

"...Mungesa e përgjegjësisë parlamentare nënkupton përjashtimin nga çdo lloj përgjegjësie, duke vepruar kështu si një privilegj përballë tentativës për të ngritur çfarëdo lloj procedimi. Është një kufij kushtetues absolut kundrejt nënshtrimit juridiksionit gjyqësor....."

KANADA. Gjykata Supreme e Kanadasë, *Cour Suprême du Canada, Canada (Chambre des communes) c. Vaid, 2005 CSC 30*, cit par 40 (<http://scc-csc.lexum.com/decisia-scc-csc/scc-csc/scc-csc/fr/item/2231/index.do>);

"...Nëse ekzistenca e privilegjit parlamentar vërtetohet, shqyrtimi gjyqësor i çështjes përfundon..... Pasi pranohet nga gjykata ekzistenca e privilegjit parlamentar, i përket vetëm parlamentit, dhe vetëm tij, tijapërrugëse jo akteve që pretendohen si shkelje e të drejtave..... Gjykatat nuk mund të veprojnë për të pranuar dhe hapur një proces për të konflikt: Parlamenti është i padepërtueshëm dhe domjetimundshëm gjyqësor, pavarësisht se fakti është shkaktuar apo jone parlamentar. Pasi është vendosur ekzistenca e privilegjit parlamentar, vetëm Parlamenti mund të vendosë nëse do të procedojë apo jo për hetimin dhe gjykimin e pretendimit për shkeljen e një të drejte"

SHBA. Kongresit kapushtetint e deklarojnë në një individ kakryernjë "contempt of Congress" (Shënim: shpërfillje, fyerje, pengim ose kundërshtim i autoritetit të Kongresit) nëse sjellja ose veprimet e këtij individ pengon punimet e Kongresit. Kypushtet është i lidhur në mënyrë të pandashme me juridiksionin e Kongresit për të hetuar dhe vendosur në rastet e tilla. Ai është thelbësor për realizimin e funksionit legjislativ, është pjesë e përbërëse e autoritetit dhe pushtetit të dhënë Kongresit nga Kushtetuta *

* Gjykata e Lartë. *US Supreme Court, McGrain v. Daugherty*, 273 U.S. 135 (1927)

* Gjykata e Lartë. *US Supreme Court, Sinclair v. United States*, 279 U.S. 263 (1929) :

a. të pandehurit Arben Ndoka dhe Pjerin Ndreu janë deputetë të Kuvendit. Gjithashtu, edhe personi i dëmtuar Gent Strazimiri është deputet i Kuvendit;

b. në datën 10.07.2014, Kuvendi i Shqipërisë ishte i mbledhur në seancë plenare;

c. në debatin parlamentar që po zhvillohej në këtë seancë plenare të Kuvendit, ishin të pranishëm, në cilësinë e deputetit, të pandehurit Arben Ndoka dhe Pjerin Ndreu, si edhe i dëmtuari Gent Strazimiri;

ç. në rendin e ditës së punimeve të kësaj seance plenare ishte edhe debati e votimi i projektligjit *“Për armët”*;

d. mes të tjerëve, gjatë debatit parlamentar, ka marrë fjalën i dëmtuari Gent Strazimiri, si deputet i Partisë Demokratike, duke shprehur edhe qëndrimin se Kryeministri të mos i vishte me pushtet njerëz të botës së krimit dhe tu hiqte sa më parë mandatin e deputetit personave me rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe të dënuar për vepra të rënda penale;

dh. gjatë fjalës së tij kanë qenë të pranishëm në sallën e seancave plenare edhe dy deputetët e Partisë Socialiste, të pandehurit Arben Ndoka dhe Pjerin Ndreu;

e. pasi ka përfunduar diskutimet e tij, ndërkohë që debati parlamentar vazhdonte, i dëmtuari Gent Strazimiri, është larguar nga salla ku zhvillohen punimet e Kuvendit, për një pushim të shkurtër, duke qëndruar në ambientet e tij, në korridorin në krah të sallës plenare;

ë. duke pasur si motiv mospajtimin e thellë me fjalët e thëna dhe opinionet e shfaqura nga i dëmtuari Gent Strazimiri në adresë të grupit të deputetëve ku bënte pjesë, i ndjerë i fyer dhe i cenuar edhe në figurën e tij të deputetit nga atribuimi që u bëhej si politikanë e deputetë si të lidhur me krimin apo të ardhur nga bota e krimit, i pandehuri Arben Ndoka reagon duke u larguar edhe ai nga salla e seancës plenare në drejtim të ambientit ku ndodhej i dëmtuari Gent Strazimiri dhe duke kryer veprime të dhunshme goditëse ndaj tij, veprim i cili është ndalur menjëherë nga ndërhyrja e shërbimit parlamentar dhe deputetëve të tjerë;

f. në ndërkohë, aty ka ardhur edhe deputeti tjetër, i pandehuri Pjerin Ndreu, i cili, duke identifikuar praninë e të dëmtuarit Gent Strazimiri mes grupit të deputetëve dhe punonjësve të shërbimit parlamentar, për të njëjtat motive sikurse i pandehuri tjetër Arben Ndoka por në mënyrë të pavarur nga ky i fundit, i është drejtuar me fjalë fyese e duke reaguar ndaj t të dëmtuarit Gent Strazimiri me veprime të dhunshme, të cilat u penguan nga personat e tjerë të pranishëm;

g. deputetit të dëmtuar Gent Strazimiri nuk i janë shkaktuar pasoja në shëndet nga veprimet e dhunshme goditëse të të pandehurve Arben Ndoka dhe Pjerin Ndreu.

68. Nisur nga këto rrethana të faktit të vërtetuara në gjykim, duke pasur parasysh rëndësinë dhe peshën e tyre për identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe zbatimit të drejtë të tij të analizuar hollësisht më sipër në këtë vendim, Kolegjit Penal i rezulton se:

a. ngjarja objekt gjykimi ka ndodhur në ambientet e Kuvendit;

b. ngjarja objekt gjykimi ka ndodhur gjatë një lloji të veprimtarisë parlamentare (seancës plenare);

c. ngjarja objekt gjykimi ka ndodhur në lidhje me zhvillimet e veprimtarisë parlamentare, me çështjet e debatit që zhvillohej në atë seancë;

ç. i dëmtuari Gent Strazimiri dhe të pandehurit Arben Ndoka dhe Pjerin Ndreu janë deputetë të Kuvendit;

d. i dëmtuari Gent Strazimiri ishte duke ushtruar funksionin e tij të deputetit në atë seancë plenare, duke shprehur fjalën dhe mendimet që kishte, mes të tjerave, edhe për integritetin e Kuvendit dhe cenimin e tij nga prania e deputeteve të maxhorancës me të kaluar kriminale dhe dënime penale;

dh. të pandehurit Arben Ndoka dhe Pjerin Ndreu, si deputetë të Kuvendit, kanë menduar dhe vlerësuar si të papranueshme, të pavërteta dhe ofensive ndaj figurës së tyre parlamentare fjalët dhe qëndrimet e deputetit të dëmtuar Gent Strazimiri në debatin parlamentar;

e. në përgjigje të deklarimeve të deputetit të dëmtuar Gent Strazimiri në debatin parlamentar dhe pakënaqësisë së tyre për përmbajtjen e tyre, në mënyrë të pavarur nga njëritjetri, deputetët e pandehur Arben Ndoka dhe Pjerin Ndreu, kanë reaguar, por në mënyrë të papërmbajtur, të shoqëruar me veprime të dhunshme dhe shprehje fyese që tejkalojnë lirinë parlamentare;

ë. pra ngjarja nuk ka ndodhur për motive private, të lidhura me rrethanat, interesat dhe cilësitë personale të të dëmtuarit apo të të pandehurve;

f. deputeti i dëmtuar Gent Strazimiri nuk ka pasur pasoja të natyrës shëndetësore nga veprimet materiale të dhunshme të kryera ose të tentuara nga ana e deputetëve Arben Ndoka dhe Pjerin Ndreu, të pandehur në gjykim;

j. në lidhje me këtë ngjarje dhe për shkeljet disiplinore të konstatuara në veprimet e kryera nga ana e deputetëve, bazuar në dispozitat e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr.14, datë 11.07.2014, Byroja e Kuvendit ka vendosur të ndëshkojë deputetët Arben Ndoka dhe Pjerin Ndreu me masa disiplinore të përjashtimit nga pjesëmarrja në komisionet parlamentare dhe në seancë plenare.

69. Mbi këto përfundime të lidhura mbi rrethanat e faktit, duke interpretuar ligjin e zbatueshëm lidhur me to, Kolegji Penal vlerëson se reagimi i të pandehurve është në tejkalim të lirisë parlamentare të fjalës, mendimit dhe qëndrimeve në ushtrim të mandatit të deputetit të garantuar dhe parashikuar nga neni 73 i Kushtetutës. Shprehje, sjellje e veprime të tilla nga nenet 62, 64 dhe 65 të Rregullores së Kuvendit, i parashikojnë si shkelje disiplinore apo shkelje të rënda disiplinore, të ndëshkuara sipas masave disiplinore përkatëse (neni 63) që çmohen se duhet të gjejnë zbatim nga ana e Kryetarit dhe Byrosë së Kuvendit.

69.1 Edhe kërcënimi dhe kryerja e veprimeve materiale e të dhunshme fizike nga ana e deputetit kundër një deputeti tjetër, nga njëra anë, përbën tejkalim të lirisë parlamentare në ushtrimin e mandatit nga ana e deputetëve agresues, të pandehurve Arben Ndoka dhe Pjerin Ndreu.

69.2 Deputeti gëzon lirinë e shprehjes së mendimit, të qëndrimit dhe të votimit, me anë të fjalës me gojë, me shkrim, me anë të debatit apo propozimeve legislative, madje edhe me anë të gjesteve dhe veprimeve materiale e konkludente të lejuara sipas rregullave përkatëse të miratuara, të kryera në ambientet e Kuvendit, gjatë veprimtarisë parlamentare dhe në lidhje me çështjen që debatohet në atë veprimtari parlamentare.

69.3 Por, përdorimi i shprehjeve fyese dhe kryerja e kërcënimeve dhe veprimeve të dhunshme, si mjet për të reaguar apo për të shprehur qëndrimin mospranues me atë të një deputeti tjetër, sikurse kanë vepruar të pandehurit Arben Ndoka dhe Pjerin Ndreu, nuk tregojnë përdorim të rregullt dhe respektim të lirisë e të privilegjeve parlamentare të tyre si deputetë të Kuvendit dhe as të autoritetit të Kuvendit.

69.4 Nga ana tjetër, sjellje të tilla të të pandehurve Arben Ndoka dhe Pjerin Ndreu si deputetë të Kuvendit, kundër deputetit e sulmuar, të dëmtuarit Gent Strazimiri, me shprehje fyese dhe veprime materiale të dhunshme, shkaktojnë cenimin e lirisë parlamentare në ushtrimin e rregullt dhe të lirë të mandatit të tij si deputet. Njëkohësisht cenohet edhe autoriteti dhe funksionimi kushtetues i Kuvendit.

69.5 Pozita e deputetit të dëmtuar Gent Strazimiri, liria e tij parlamentare, mbrohet dhe garantohet nga Kushtetuta. Ndërsa, të pandehurit Arben Ndoka dhe Pjerin Ndreu, si deputetë të Kuvendit, nuk mbulohen nga garancia kushtetuese e mungesës së përgjegjësisë për fjalët dhe

aktet e kryera si deputet gjatë ushtrimit të mandatit. Si rrjedhojë, ata i nënshtrohen përgjegjësisë disiplinore për këto shkelje të Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit.

69.6 Fjale dhe sjellje të tilla, sikurse ato të konsumuara nga të pandehurit Arben Ndoka dhe Pjerin Ndreu si deputetë të Kuvendit, ndonëse të kryera në ambientet e Kuvendit, gjatë një veprimtarie parlamentare dhe të lidhura me çështjet në debat parlamentar, e tejkalojnë lirinë parlamentare që u njeh atyre Kushtetuta, duke sjellë si pasojë cenimin e autoritetit dhe veprimtarisë së Kuvendit kolektivisht, si edhe lirinë parlamentare të deputetëve të tjerë individualisht, sikurse është rasti i të dëmtuarit Gent Strazimiri si deputet e Kuvendit.

70. Të pandehurit Arben Ndoka dhe Pjerin Ndreu, si deputetë të Kuvendit, në këtë rast, nuk mund të mbrohen me privilegjin e mungesës së përgjegjësisë për fjalët, qëndrimet dhe veprimet e tij në ushtrim të mandatit dhe sjellja e tyre duhet të ndëshkohet. Por, përderisa ngjarja ka ndodhur në ambientet e Kuvendit, gjate veprimtarisë parlamentare (seancës plenare) dhe për çështje e motive të lidhura me debatin parlamentar, nisur nga pozicioni reciprok i parlamentarit, pra nuk ka ndodhur për çështje private dhe as për çështje që nuk kanë lidhje me funksionin e deputetit, atëherë, ne interpretim dhe zbatim të Kushtetutës dhe të Rregullores së Kuvendit:

a. i përket ekskluzivisht vetë Kuvendit të verifikojë, hetojë dhe shqyrtojë rastin, sipas procedurave dhe kompetencave të përcaktuara nga organet e tij;

b. i përket ekskluzivisht Kuvendit të vlerësojë dhe vendosë nëse jemi apo jo përpara shkeljes dhe tejkalimit të lirisë parlamentare të parashikuar nga Kushtetuta dhe Rregullorja e Kuvendit;

c. i përket ekskluzivisht Kuvendit të vendosë nëse do të ndëshkojë apo jo deputetin përgjegjës disiplinarisht, si edhe për llojin dhe masën disiplinore përkatëse.

71. Pas këtij hetimi dhe gjykimi disiplinor, asnjë autoritet tjetër jashtë Kuvendit, përfshirë edhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk mund të investohen për të filluar një procedim, hetim apo gjykim administrativ, civil ose penal. Më tej, nëse i është paraqitur çështja nga të tretë apo autoritete të tjera, pasi të ketë verifikuar natyrën e çështjes, ekzistencën e privilegjit parlamentar dhe të juridiksionit ekskluziv të Kuvendit, asnjë gjykatë e hallkave të pushtetit gjyqësor nuk mund të vijojë me shqyrtimin e çështjes, duke u detyruar që ta pushojë atë.

72. Në çështjen objekt gjykimi, mbi kallëzimin e bërë nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike në datën 14.07.2014, Prokuroria e Përgjithshme ka regjistruar procedimin penal nr.01 të vitit 2014 dhe, pasi ka përfunduar hetimet paraprake, ka sjellë për gjykim para Gjykatës së Lartë të pandehurit Arben Ndoka dhe Pjerin Ndreu, të akuzuar për veprën penale të goditjes për shkak të detyrës të të dëmtuarit Gent Strazimiri, parashikuar nga neni 237 i Kodit Penal.

73. Kolegji Penal vlerëson se organi i prokurorisë ka zbatuar gabim Kushtetutën dhe ligjin material e procedural penal, për shkak se nuk ka përmbushur detyrimin kushtetues dhe ligjor për të verifikuar edhe paraprakisht, me paraqitjen e kallëzimit dhe kryerjen e veprimeve të para, nëse nisur nga rrethanat e faktit, natyra dhe cilësitë e subjekteve, natyra e veprimeve të atribuara të të dëmtuarit dhe personave të treguar si autorë të shkeljes së ligjit, çështja bënte pjesë në juridiksionin penal apo në atë ekskluziv të Kuvendit.

73.1 Përkundrazi, organi i prokurorisë ka kryer të gjitha veprimet që i përkasin fazës së hetimit paraprak dhe, në përfundim, ka paraqitur kërkesën për gjykim në Gjykatën e Lartë ndaj të pandehurit Arben Ndoka dhe Pjerin Ndreu, me akuzën e kryerjes prej tyre të veprën penale të goditjes për shkak të detyrës të të dëmtuarit Gent Strazimiri, parashikuar nga neni 237 i Kodit Penal.

73.2 Ndërkohë që, në rrethanat konkrete të kësaj çështje dhe nisur nga parimet e normat kushtetute dhe rregullatore të Kuvendit, në interpretim dhe zbatim të drejtë të nenit 290 pika 1

shkronja “ç” të Kodit të Procedurës Penale, duhet të kishte vendosur mosfillimin e procedimit apo pushimin e tij.

74. Gjykata e Lartë është investuar për shqyrtimin e kësaj çështje në shkallë të parë, bazuar në juridiksionin fillestar që i ngarkon Kushtetuta (neni 141) për gjykimin e akuzës penale kundër deputetëve të Kuvendit.

75. Duke vepruar si gjykatë e shkallës së parë në gjykimin e çështjes penale mbi akuzën e ngritur nga prokurori, Kolegji Penal nuk mund të disponojë menjëherë me fillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas nenit 387 të Kodit të Procedurës Penale, qoftë edhe për motivin se jemi përpara juridiksionit gjyqësor penal apo juridiksionit ekskluziv të Kuvendit. Kjo për arsyen se ky disponim duhet të bazohet në prova dhe në ligj, ndërkohë që gjykata mund të njihet me provat vetëm pas paraqitjes dhe debatimit të tyre në seancë gjyqësor.

76. Pasi u njoh dhe vlerësoi e çmoi provat nëpërmjet debatit gjyqësor, duke pranuar të vërtetuarat rrethanat e faktit dhe ligjin e zbatueshëm lidhur me to, sikurse parashtrohet më sipër në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji Penal vjen në përfundimin se kjo çështja penale e paraqitur për gjykim nga Prokuroria e Përgjithshme nuk është në juridiksionin gjyqësor penal.

Ajo i përkiste juridiksionit ekskluziv të Kuvendit, i cili, madje edhe e kishte shqyrtuar rastin duke e kualifikuar si cenim të lirisë parlamentare dhe të funksionimit të Kuvendit duke i ndëshkuar deputetët përgjegjës, të pandehur në këtë gjykim, me masat disiplinore përkatëse.

77. Prandaj, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në zbatim të pikës 1 të nenit 387 të Kodit të Procedurës Penale, vjen në përfundimin se duhet të vendoset pushimi i çështjes penale në ngarkim të pandehurit Arben Ndoka dhe të pandehurit Pjerin Ndreu, për shkak se ndjekja penale nuk duhej të fillonte.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke u bazuar në nenet 387/1 dhe 190 të Kodit të Procedurës Penale;

V E N D O S I

Pushimin e çështjes penale në ngarkim të pandehurit Arben Ndoka, i akuzuar për veprën penale të goditjes për shkak të detyrës, parashikuar nga neni 237 i Kodit Penal, për shkak se ndjekja penale nuk duhet të fillonte.

Pushimin e çështjes penale në ngarkim të pandehurit Pjerin Ndreu, i akuzuar për veprën penale të goditjes për shkak të detyrës, parashikuar nga neni 237 i Kodit Penal, për shkak se ndjekja penale nuk duhet të fillonte.

Provat materiale, që janë 2 (dy) CD (DVD) t'i bashkohen dosjes gjyqësore.

Tiranë, më 10.06.2015